EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5718
E mërkurë, 6 mars 2019
çmimi 0.40 €

Blerim Reka mbledh 11 000 nënshkrime për kandidaturën për president

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË KAZERMËN "ADEM JASHARI" ËSHTË MBAJTUR CEREMONIA USHTARAKE NË NDERIM TË 21-VJETORIT TË "EPOPESË SË UÇK-SË"

FAQE 3

RIFAT JASHARI: USHTRIA E KOSOVËS TA MBROJË TERRITORIN ASHTU SIÇ E MBROJTI UÇK-ja

Me nderime të larta shtetërore krerët institucionalë kanë kujtuar sakrificën e pashembullt të familjes Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Në manifestimin qendror në shënim të 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së" organizuar të martën, është thënë se sakrifica e kësaj familje bëri kthesë të jashtëzakonshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Rifat Jashari, vëllai i Adem Jasharit, ka kërkuar që Ushtria e Kosovës të jetë e gatshme ta mbrojë territorin e Kosovës ashtu siç e kishte mbrojtur Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)

ANALISTËT POLITIKË KËRKOJNË REFLEKTIM NGA SPEKTRI POLITIK PËR PEZULLIMIN E TAKSËS

FAQE 4-5

ANALISTËT KËRKOJNË PEZULLIMIN E TAKSËS ME KUSHTE

Synohet themelimi i 'Air Kosova'

FAQE 7

AKTUALE

RRËFIMI IM PËR 5 MARSIN 1998

F. 11

Shkruan: Blerim LATIFI

GJOBAT NUK PAKËSOJNË VDEKJET NGA AKSIDENTET NË TRAFIK

F. 11

MINISTRJA HOXHA AUTORIZOHET PËR T'I NËNSHKRUAR FONDET E IPA 2018

F. 5

EKONOMI

AMBASADORI KOSNETT THOTË SE TREGTIA E PAPENGUAR RAJONALE NDIKON NË TËRHEQJEN E INVESTIMEVE

F. 9

SHALA KËRKON QË BIZNESET TË BEHEN PJESË E HARTIMIT TË LIGJIT PËR TREGTI TË BRENDSHME

F. 9

KULTURË

'LIBRI I LUFTËS', SIRTAR I ARKIVIT TË LUFTËS

F. 12

Muhamet MAVRAJ, *redaktor i librit*

SPORT

HALITI: MPOSHTIM FERONIKELIN DHE ZBUSIM DIFERENCËN

F. 14

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Përplasje dhe tensione në protestën e opozitës para Kuvendit

Tiranë, 5 shkurt - Opozita e ndjekur nga mijëra mbështetës dhe simpatizantë të saj ka protestuar para Kuvendit me moton kryesore: "Rama, ik!" Paralelisht në Kuvend është zhvilluar seanca plenare, ku janë betuar edhe katër deputetët e rinj që morën mandatet një ditë më parë nga KQZ-ja. Në orën 12:00 kanë nisur edhe incidentet e para serioze. Protestuesit kanë hedhur shashka në drejtim të kordonit të policisë.

Në pedonalen para Parlamentit dhe në rrugët lidhëse ka pasur forca të shumta policore. Ajo ka qenë e mbyllur dhe nuk lejohej kalimi i personave të tjerë. Efektivë të shumtë, rreth 1 000 të tillë, kanë marrë masa për të mos lejuar protestuesit që të afrohen në sheshin përpara Parlamentit. Kordonët e policisë kanë mbrojtur të gjitha hyrjet e Kuvendit. Mes thirrjeve të forta "Rama, ik!", me të cilat shpërthyen protestuesit e mbledhur para Kuvendit, kreu i PD-së, Lulzim Basha, ka theksuar se sovrani e ka marrë vendimin dhe regjimi i Ramës ka rënë.

Pas fjalës ai ka ftuar protestuesit ta ndjekin nga pas, drejt KQZ-së, për ta bërë hapin e radhës, për ta formalizuar djegien e mandateve të vijuesve në listat e kandidatëve të opozitës për deputetë. "Sovrani e ka marrë vendimin, e ka kuptuar fare mirë. Prej javësh ajo godinë nuk është godina e Kuvendit të Shqipërisë, por godina e kolerës së krimit dhe korrupsionit", tha Basha.

Pas zgjidhjes së emrit, fokusi në përmbushjen e reformave

Zëvendëskryeministri për çështje evropiane në Maqedoninë e Veriut, Bujar Osmani, ka thënë se duhet të përkushtohemi për kryerjen e detyrave tona të brendshme në drejtim të reformës gjyqësore, administratës publike, shërbimeve të inteligjencës, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Shkup, 5 shkurt - Pas zgjidhjes së çështjes së emrit me Greqinë, institucionet e Maqedonisë së Veriut thonë se prioritet numër një do ta kenë zbatimin e reformave, me qëllim marrjen e datës për nisjen e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Kjo nuk do të thotë se ne tani duhet të rrimë duarkryq për shkak se kemi mbyllur temat e mëdha politike. Në fakt, duhet të përkushtohemi për kryerjen e detyrave tona të brendshme në drejtim të reformës gjyqësore, administratës publike, shërbimeve të inteligjencës, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit", ka deklaruar zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani.

I pyetur për ngecjen e reformave, Osmani para mbledhjes së Komitetit punues qeveritar për çështje evropiane, ka thënë se ngecje mund të ketë, por se qëllimi nuk është në përshpejtimin e reformave, por në cilësinë e tyre. "Gjithmonë parimi ynë ka qenë cilësia para shpejtësisë. Pra, shumë me rëndësi është të ketë reforma cilësore, të cilat në esencë do ta përmirësojnë punën e këtyre institucioneve shumë të rëndësishme për qytetarët. Por, natyrisht se nuk duhet edhe t'i stërzgjatim këto reforma për shkak se duhet t'i bindim vendet anëtare të BE-së që në qershor të marrim një vendim me konsensus për nisjen e bisedimeve në vitin 2019", thotë Osmani.

Temellko Ristevski, profesor i administratës publike në Universitetin Fon të Shkupit, thotë se reformat duhet të kryhen me vendosjen e njerëzve të aftë dhe që kanë vullnet të jenë të shërbim të qytetarëve. Por, reforma, sipas tij, duhet të zhvillohet me kujdes për shkak të numrit të madh të punonjësve në këtë sektor. "Administrata mund të jetë efikase vetëm nëse njerëzit e vërtetë vendosen në pozitat kyçe. Një njeri që di dhe dëshiron të punojë mund të jetë edhe efikas në punë. Reformat në administratë janë të dhimbshme, por të domosdoshme. Ky proces duhet të zhvillohet me kujdes që të mos kalojmë në problem social, pasi nëse përnjëherë largohen nga puna dhjetamijëra punonjës, kjo do të shkaktonte problem të madh social", thotë profesori Ristevski.

Reformat në administratë, gjyqësor, pastaj lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, është kërkuar në vazhdimësi nga institucionet ndërkombëtare, por apelet e tyre kanë mbetur nën hijen e kontestit të emrit me Greqinë, që tashmë është zgjidhur, por që ka nxjerrë në sipërfaqe kërkesat për realizimin e reformave. Kjo është kërkuar edhe nga ShBA-ja.

Ndihmëssekretari ardhshëm i Shtetit për Evropë dhe Azi, Philip Reeker, gjatë qëndrimit të hënën në Shkup tha se qytetarët duhet t'i ndiejnë reformat, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e vendit. "Me rëndësi është që qytetarët ta ndiejnë nivelin e transparencës, nivelin e përgjegjësisë, të dinë se sundimi i së drejtës të jetë aspekti më i rëndësishëm që do të unifikojë vendin. Këtu bën pjesë edhe sistemi i drejtësisë për të cilin duhet të punohet dhe po shohim se një për një pjesë të ligjeve ka mbështetje edhe nga opozita dhe vlerësoj se këtu qëndron edhe suksesi i Maqedonisë së Veriut", ka deklaruar diplomati amerikan Philip Reeker.

Blerim Reka mbledh 11 000 nënshkrime për kandidaturën për president

Shkup, 5 mars (ER) - Diplomati Blerim Reka tashmë edhe zyrtarisht është kandidat për president të Maqedonisë së Veriut. Kandidatura e tij është zyrtarizuar pas mbledhjes së 11 000 nënshkrimeve. Shtabi qendror i kandidatit për president ka falënderuar strukturat e partive politike për kontributin dhe mbështetjen e dhënë në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve. "Ju njoftojmë se kandidati i pavarur shqiptar, prof. dr. Blerim Reka, tashmë edhe zyrtarisht është kandidat për zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut. Duhet theksuar se në më pak se 15 orë, Reka e kanë mbështetur mijëra qytetarë, që konfirmuan përmes mbi 11 000 nënshkrimeve, mbështetjen e fuqishme të kandidaturës së tij. Falënderojmë strukturat e partive politike, Aleancës për Shqiptarët dhe Lëvizjes Besa, për kontributin dhe mbështetjen e dhënë në procesin e mbledhjeve të nënshkrimeve. Po ashtu, falënderojmë të gjithë qytetarët për mbështetjen: guximin e gjejmë në përkushtimin tuaj", është thënë në njoftimin e publikuar në "Facebook" nga shtabi qendror i kandidatit për president të Maqedonisë së Veriut, Blerim Reka.

Vdes ish-ministri i Jashtëm gjerman, Klaus Kinkel

Berlin, 5 shkurt - Ish-ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Klaus Kinkel, ka vdekur në moshën 82-vjeçare. Kinkeli ka shërbyer si ministër i Jashtëm prej vitit 1992 deri në vitin 1998. Ai ka udhëhequr Shërbimin e Inteligjencës gjermane në vitet 1979-'82.

Kinkel ka shërbyer edhe si ministër i Drejtësisë në kabinetin e kancelarit Helmut Kol.

Ministri i Jashtëm aktual, Heiko Maas, shkroi në "Twitter" se Kinkel "ka kontribuar shumë për Gjermaninë e ribashkuar, për ta gjetur vendin e saj në botë dhe për të jetuar në paqe dhe respekt me fqinjët e saj".

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Në Kazermën "Adem Jashari" është mbajtur ceremonia ushtarake në nderim të 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së"

Rifat Jashari: Ushtria e Kosovës ta mbrojë territorin ashtu siç e mbrojti UÇK-ja

Me nderime të larta shtetërore krerët institucionalë kanë kujtuar sakrificën e pashembullt të familjes Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Në manifestimin qendror në shënim të 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së" organizuar të martën, është thënë se sakrifica e kësaj familje bëri kthesë të jashtëzakonshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Rifat Jashari, vëllai i Adem Jasharit, ka kërkuar që Ushtria e Kosovës të jetë e gatshme ta mbrojë territorin e Kosovës ashtu siç e kishte mbrojtur Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 MARS - Rifat Jashari, vëllai i komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Adem Jashari, ka kërkuar që Ushtria e Kosovës të jetë e gatshme ta mbrojë territorin e Kosovës ashtu qysh e ka mbrojtur Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Në manifestimin qendror në shënimin e 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së", ai i ka dëshiruar sukses Ushtrisë së Kosovës. "Sot jemi bashkuar këtu, më 5 mars, para ushtrisë më të re të kombit shqiptar, Ushtrisë së Kosovës. Dëshiroj t'ju përshëndes të gjithëve këtu dhe gjithë shqiptarët kudo që janë. Ushtrisë së Kosovës i dëshiroj suksese dhe lumturi që gjithmonë të jetë e gatshme ta mbrojë territorin e vendit tonë ashtu qysh e mbrojti Ushtria Çlirimtare e Kosovës", ka thënë Jashari.

Ai ka falënderuar ShBA-në dhe shtetet e tjera mike të Kosovës për ndihmën që kanë dhënë dhe vazhdojnë ta japin për shtetin tonë. "Lavdi dhe nder të gjithë atyre që kanë rënë më herrët dhe më vonë, duke i falënderuar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet mike që na kanë ndihmuar dhe besojmë se prapë kanë për të na ndihmuar deri në fund, që t'i zgjedhim problemet që i kemi përpara. Lavdi dhe nder juve dhe gjithë kombit shqiptar!", është shprehur Rifat Jashari.

Me këtë rast, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se me nderimet më të larta shtetërore Kosova sot kujton sakrificën e pashembullt të familjes Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Kjo sakrificë sublime, sipas tij, bëri kthesë të jashtëzakonshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. "Bota filloi ta kuptojë drejt Kosovën. 'Epopeja e UÇK-së' dëshmoi se kthim prapa nuk kishte në luftën tonë për liri dhe çlirim. UÇK-ja u bë projekti më madhor kombëtar në historinë e kombit shqiptar", ka shtuar ai.

Kreu i shtetit ka thënë se sot dhe gjithmonë nderojmë të gjithë dëshmorët e lirisë, invalidët, veteranët dhe gjithë qytetarët që sakrifikuan për çlirimin e Kosovës. "Nderojmë diasporën që dha gjithçka për liri. Kujtojmë 13 500 civilë shqiptarë të vrarë, rreth 400 masakra kundër shqiptarëve, rreth 20 000 gra të dhunuara shqiptare", ka thënë presidenti Thaçi para qindra ushtarëve të rreshtuar për nder të 21-vjetorit të 'Epopesë së UÇK-së".

I pari i vendit ka thënë se në këtë përvjetor për herë të parë "Epopenë e UÇK-së" po e shënojmë me Ushtrinë e Kosovës, të njohur edhe ndërkombëtarisht si forcë moderne, profesionale dhe shumetnike. "Ecja e Kosovës përpara është e pandalshme. Po konsolidohemi në rrafshin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Të bashkuar si popull dhe institucione kemi energji që të bëjmë hapa gjigantë. Të bashkuar miqtë do të na përkrahin edhe më shumë", ka thënë Thaçi.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se heronjtë dhe dëshmorët e Kosovës, veçanërisht Jasharët dhe komandanti legjendar Adem Jashari, ndryshuan rrjedhat e ngjarjeve për Kosovën. "Në marsin e 1998-s midis Evropës u shua një familje, por bota e lirë u zgjua dhe nuk lejoi të zhdukej një popull, i cili, nga historia evropiane dhe botërore, kishte mësuar ndër breza të jetojë i lirë, në vend të vetin, me nder dhe dinjitet. Dhe duke i respektuar të tjerët që jetojnë pranë tij. Heronjtë dhe dëshmorët e Kosovës, veçanërisht Jasharët dhe komandanti legjendar Adem Jashari, na kanë dhënë këtë leksion: Vetëm një popull që është i gatshëm ta mbrojë lirinë me çmimin e jetës, e ka të ardhmen e sigurt!", është shprehur Haradinaj.

I pari i Qeverisë ka folur edhe për procesin e formimit të Ushtrisë së Kosovës. "Të zgjedhurit e popullit të Kosovës me 107 vota i thanë po një projekti nacional që vjen në formë euroatlantike, që ka qëllim paqen dhe që i dedikohet paqes. Shërbimi në Forcën e Kosovës do të jetë nder dhe privilegj, edhe patriotizëm i gjithë qytetarëve që jetojnë në Kosovë dhe atyre të komuniteteve etnike. Sot, këtu, ritakohen në rresht të gjithë brezat e çlirimtarëve të Kosovës, të mishëruar në flamurin e ushtrisë sonë të paqes dhe flamurtari i parë, eprori i të gjithë eprorëve, gjenerali ynë, gjenerali i gjithë gjeneralëve, komandanti ynë Adem Jashari. Ushtria e Kosovës vjen në paqe dhe ajo nuk do të përdoret kundër popullit të Kosovës, as në jug dhe as në veri. Por, ajo do të jetë aty për paqe për të gjithë që jetojnë në Kosovë", ka thënë ai.

Pas rivistës që ua ka bërë kuadrateve të FSK-së presidenti Hashim Thaçi dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, dhe pas intonimit të himnit shtetëror dhe atij kombëtar, në këtë ceremoni presidenti Thaçi, kryeministri Haradinaj, ministri i Mbrojtjes, Berisha, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, kanë vendosur kurora me lule pranë obeliskut të dëshmorëve, në kujtim dhe nderim të gjithë dëshmorëve të kombit të rënë për liri. Manifestimi, më 5, 6 dhe 7 mars 2019, për shënimin e "Epopesë ë UÇK-së", po mbahet nën përkujdesjen e kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj.

Thaçi bën homazhe në Prekaz

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka bërë homazhe në kompleksin memorial "Adem Jashari" në nder të 21-vjetorit të shënimit të Epopesë së UÇK-së. "Epopeja e UÇK-së më 5, 6 dhe 7 mars bëri kthesë historike për Kosovën, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Sakrifica heroike e familjes Jashari, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, ishte e pashembullt dhe hapi shtegun e lirisë dhe pavarësisë sonë. Vitet po shkojnë, por madhështia e figurës së Adem Jasharit do të vazhdojë të rritet edhe më shumë. Kryekomandanti dhe familja Jashari janë simbol i pavarësisë së Kosovës për shqiptarët anekënd botës. Lavdi e përjetshme për të gjithë dëshmorët e kombit!", ka thënë presidenti Thaçi.

Analistët politikë kërkojnë reflektim nga spektri politik për pezullimin e taksës

Analistët kërkojnë pezull

Njohësit e proceseve politike kanë vlerësuar se taksa ndaj produkteve serbe ka arritur efektin dhe tani është koha për një reflektim të përbashkët të partnerëve të koalicionit qeverisës për ta pezulluar atë për një periudhë të caktuar. Analisti politik Shkëlzen Maliqi dhe profesori Afrim Hoti kanë thënë se pezullimi nuk nënkupton heqje të taksës, por i hap rrugë vazhdimit të dialogut dhe arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë. Sipas tyre, ka ardhur koha që për të fituar diçka Kosova duhet ta pezullojë taksën, në të kundërtën gjasat janë që Kosova do të detyrohet që ta heqë taksën pa përfituar asgjë

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 MARS - Analistët politikë i kanë bërë thirrje spektrit politik që të reflektojë lidhur me pezullimin e taksës ndaj Serbisë. Por, sipas tyre, pezullimi i taksës duhet të kushtëzohet në mënyrë që Kosova të mos dalë humbëse nga ky proces. Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë të martën se është e domosdoshme heqja e taksës. Ai ka theksuar se pezullimi i taksës pezullon edhe bllokadën serbe të dialogut dhe marrëveshjes që ka për synim njohjen e Kosovës nga Serbia. Maliqi ka thënë se nuk është e vërtetë se diplomatët e huaj i bëjnë presion vetëm Kosovës për taksën, ndërkaq mungon presioni ndaj Serbisë. Sipas tij, diplomatët janë duke i bërë presione edhe Serbisë që ta njohë pavarësinë e Kosovës duke theksuar se ky është kusht për integrimin e saj në BE. "Nuk është i saktë argumenti se diplomatët e huaj i bëjnë presion vetëm Kosovës për taksën, ndërkaq mungon presioni ndaj Serbisë. Diplomatët e ShBA-së dhe të Gjermanisë, po edhe top diplomatët nga BE-ja, i bëjnë presion edhe Serbisë që ta njohë pavarësinë e Kosovës, duke theksuar se ky është kusht për integrimin e saj në BE. Por, diplomacia perëndimore njohjen e Kosovës nga Beogradi e sheh si pjesë të vazhdimit të dialogut që duhet të përfundojë shpejt me një marrëveshje pajtimi dhe njohje të ndërsjellë ndërshtetërore Kosovë - Serbi", është shprehur ai.

Maliqi ka shtuar se dialogu është proces brenda të cilit duhet të prodhohen marrëveshjet obligative mes dy palëve që eliminojnë arsyet për taksën që e ka vendosur Qeveria e Kosovës për mallrat nga Serbia. "Ndërkaq, Qeveria e Serbisë e shfrytëzon taksën, përkatësisht kërkon heqjen e saj si kusht për vazhdimin e dialogut, duke e mbajtur atë të bllokuar. Andaj, presionet e diplomatëve për pezullimin e taksës dhe zhbllokimin e dialogut nuk janë të njëanshme, por godasin Kosovën dhe Serbinë me imperativin e marrëveshjes për njohje të ndërsjellë. Pezullimi i taksës pezullon edhe bllokadën serbe të dialogut dhe marrëveshjes që, nëse do të arrihet, sjell njohjen e Kosovës nga Serbia", ka shkruar Maliqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet ta pezullojë taksën ndaj Serbisë në mënyrë që t'i jepet mundësia procesit të dialogut dhe arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse. Hoti ka vlerësuar se taksa ka pasur efekt dhe tani është koha për një reflektim të përbashkët të partnerëve të koalicionit për ta pezulluar taksën për një periudhë të caktuar duke e ruajtur interesin strategjik, që është miqësia me ShBA-në. "Taksa nuk ka qenë dhe nuk duhet të interpretohet si aksion i Kosovës, por duhet të interpretohet si reaksion i Kosovës për veprimet e Serbisë. Edhe në kuptimin e brendshëm, pra në kuptimin e zhvillimit të ekonomisë dhe të konsolidimit të shtetit, taksa ka pasur efekt, por edhe në kuptimin e jashtëm qeveria aktuale, bashkë me kryeministrin, kanë treguar vendosmëri dhe kanë mbajtur në fuqi këtë vendim me peshë dhe përmasa kombëtare. Megjithatë, tani është çështja e balancimit dhe matjes në mes të ecjes më tutje pa amerikanët apo lëshimit pe për pezullimin e taksës dhe të bashkëpunimit me amerikanët si partnerët tanë strategjikë. Në kuptimin politik dhe ekonomik ka të drejtë kryeministri, kurse në kuptimin strategjik duhet të bëhet një përllogaritje dhe të shihet se cili është interesi i Kosovës. Në këtë drejtim besoj se Qeveria e Kosovës do të reflektojë pozitivisht duke e pezulluar taksën për kohë të caktuar. Ky pezullim nuk nënkupton heqje të taksës, por dhënie mundësi palës tjetër që

imin e taksës me kushte

të reflektojë në atë që njihet si marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe në mesin e kushteve do të jetë edhe njohja e Kosovës", ka deklaruar Hoti në një intervistë për gazetën "Epoka e re".

Ndërsa profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka thënë se taksa prej 100 përqindësh ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës mund të pezullohet vetëm nëse kushtëzohet me reciprocitet të plotë. Ai ka thënë se nëse taksa do të pezullohej me këtë kushtëzim, edhe bashkësia ndërkombëtare nuk do ta drejtonte gjithë presionin te pala e Kosovës. "Taksa mund të pezullohet për një kohë të caktuar vetëm nëse zëvendësohet me reciprocitet të plotë në marrëdhëniet tregtare dhe jo vetëm midis dy shteteve. Mendoj se në këtë drejtim janë edhe dhjetë kërkesat e liderit të PDK-së dhe të kreut të Kuvendit, z. Veseli", ka thënë Gashi për gazetën "Epoka e re". Sipas Gashit, pezullimi i taksës me këtë kushtëzim nuk do të ndikonte në raportet e Kosovës me ShBA-në. "Pala amerikane i ka kuptuar në masë të madhe arsyet e vendosjes së taksës, ndaj ka kërkuar pezullimin dhe jo heqjen e saj. Mendoj se, duke e pezulluar përkohësisht taksën, me kushtin që e cekëm më lart, do t'i ruanim raportet e mira me ShBA-në, diçka që është e rëndësisë primare për Kosovën", është shprehur ai.

Gashi ka thënë se është vështirë e besueshme që Serbia heqjen e taksës do ta këmbejë me njohjen e Kosovës. "Të gjitha kushtet e qeverisë janë të drejta në parim, por është vështirë e besueshme që Serbia heqjen e taksës do ta këmbente me njohjen e Kosovës. Ndoshta hapi i parë drejt njohjes është kushtëzimi i pezullimit të taksës me zbatimin e reciprocitetit të plotë midis dy shteteve si fazë testuese për Serbinë para se t'i kërkohet njohja. Mendoj se nëse taksa do të pezullohej përkohësisht me këtë kushtëzim, edhe bashkësia ndërkombëtare nuk do ta drejtonte gjithë presionin te pala e Kosovës", ka thënë Gashi.

Për çështjen e taksës ka folur edhe kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, duke thënë se deri më tani taksa i ka arritur tri qëllime kryesore. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është koha që të dëgjohen kështillat e partnerëve amerikanë për pezullim të taksës. "Deri më tani besoj se taksa i ka arritur tri qëllime kryesore. E para, ka dëshmuar se Kosova është shtet sovran që në raport me Serbinë guxon dhe merr masa reciprociteti. Pra, ka dëshmuar një sovranitet të qartë në raport me Serbinë. E dyta, kjo masë ka sensibilizuar opinionin publik, përkatësisht qytetarët e Kosovës, që t'i bojkotojnë mallrat serbe dhe të orientohen më shumë drejt prodhimeve vendore. Ka krijuar një ambient më të mirë për prodhuesit vendorë, i cili në të ardhmen do t'i ketë efektet e duhura. Gjithashtu, ndjenja e bojkotit të mallrave serbe do të mbetet pa marrë parasysh se çfarë ndodh me taksën. E fundit ka të bëjë me dëmin ekonomik që i shkaktohet Serbisë, i cili, ndonëse nuk ka ndonjë analizë të duhur, nuk mbetet pa efekte, së paku në atë pjesë të ekonomisë serbe e cila është e lidhur me eksportet në Kosovë. Njëkohësisht kjo situatë, ndonëse ende pa statistika të qarta, ka bërë që prodhimi vendor të konsolidohet dhe rritet. Thashë se shumica e këtyre efekteve do të vazhdojnë të ndihen sidomos në të ardhmen. Tani është momenti që të dëgjohen këshillat e partnerëve tanë, e sidomos amerikanëve, për pezullim të taksës", ka deklaruar Murati.

Veseli dhe Kosnetti diskutojnë për taksën

Për çështjen e taksës të martën kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i koalicionit qeveritar, Kadri Veseli, ka pritur në takim ambasadorin amerikan Philip Kosnett. Ndonëse takimi është zhvilluar pa praninë e medieve, Veseli ka folur për takimin që ka pasur me ambasadorin Kosnett. "Kosova ka orientim perëndimor. Askush nuk ka të drejtë dhe askush nuk do të na ndajë nga ShBA-ja dhe nga orientimi ynë perëndimor. Ta fuqizojmë shtetin për arsye se nuk ka nevojë t'i hapim vetvetes dilema dhe as nuk do të lejojmë t'i hapim vetes dilema. Dilemat i kemi mbyllur më 12 qershor 1999. Populli i Kosovës me sakrificë dhe me një çmim shumë të madh e ka larguar Serbinë nga Kosova, por Serbia është fqinja jonë me të cilin duam të kemi paqe. Kosova do të jetë përjetë shtet i pavarur dhe sovran dhe ky do jetë orientimi ynë", ka deklaruar Veseli të martën në Gjilan në një vizite që ka pasur në një fabrikë të mobileve.

Haradinaj: Vendimi për taksën ishte i përbashkët. Unë e mbroj atë në emër të të gjithëve

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës, e cila është mbajtur të martën, ka folur sërish për çështjen e taksës ndaj Serbisë. Ai ka thënë se pikërisht për këtë situatë jouniteti në mes të faktorit politik në tema të interesit nacional i bën dëm vendit. "Dallimet në mes nesh krijojnë paqartësi që edhe aleatët tanë të marrin një qëndrim të favorshëm për ne. Unifikimi institucional për Ushtrinë dhe Trepçën është dështmia më e mirë se së bashku mund të arrihen objektivat shtetërore. Por, ritheksoj se nuk ka ndryshim në qëndrimet e mia për taksën ndaj Serbisë dhe pajtohem me deklarimet e përfaqësuesve të tjerë institucionalë kur thonë se asnjë Qeveri nuk e rrezikon marrëdhënien me Amerikën. Këtë e rrezikojnë që të gjithë ose e ndreqin që të gjithë, por arsyeja pse e mbajmë një kurs të tillë është serioze dhe jo e rastësishme", ka thënë Haradinaj. Ai ka theksuar se duke qenë një vendim që është marrë nga të gjithë së bashku, si kryeministër vazhdon që ta mbrojë. "Unë e mbroj atë në emër të të gjithëve. Qëndroj fuqishëm në atë se duhet ta ruajmë një të drejtë tonën që është sovrane", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi. "Sa i përket dialogut me Serbinë, jemi të vetëdijshëm se është vërtet i nevojshëm, por vetëm me një kontratë që nuk përmban elemente të kontaminuara si rasti i territoreve, kufijve. Vetëm kështu mund të ekzistojë mundësia e pezullimit të taksës. Vonesat në dialog dhe kushtet që ka nxjerrë Serbia për Kosovën nuk janë në frymën e anëtarëve që aspirojnë drejt anëtarësimit në BE. Dhe e kam thënë shumë qartë se njohja e Serbisë ndaj Kosovës do të vijë në kufijtë ekzistues, në Kosovën e 17 shkurtit. Ky është interes i të gjithë neve, i të gjithë qytetarëve të Kosovës!", ka thënë Haradinaj.

Ministrja Hoxha autorizohet për t'i nënshkruar fondet e IPA 2018

PRISHTINË, 5 MARS (ER) - Në mbledhjen e rregullt të Qeverisë së Kosovës, të martën është shqyrtuar propozim-vendimi për autorizimin e ministres së Integrimit, Dhurata Hoxha, për ta nënshkruar marrëveshjen financiare Kosovë - BE, IPA 2018. Ky propozim u miratua nga kabineti qeveritar dhe ministrja Hoxha me këtë votim merr autorizimin për nënshkrimin e marrëveshjes financiare IPA 2018, në emër të Kosovës me BE-në, me vlerë 90.5 milionë euro.

Në mbledhjen e Qeverisë, ministrja Hoxha ka folur edhe për Zbatimin e Programit Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (PKZMSA) gjatë vitit 2018. "Shkalla e përgjithshme e zbatimit të programit të MSA-së gjatë vitit 2018 është 68.23 për qind, pasi që 363 nga 532 masat janë zbatuar, derisa performanca e vitit 2018 për 6 për qind ka qenë më e mirë krahasuar me vitin paraprak", ka bërë me dije ministrja Hoxha. Ajo ka shtuar se shkalla e zbatimit të masave legjislative është 55.56 për qind, pasi që 80 nga 144 masa të planifikuara janë zbatuar. "Ndërsa shkalla e zbatimit të masave zbatuese është 72.94 për qind, pasi që 283 nga 388 masa të tilla të planifikuara janë zbatuar", ka thënë ministrja Hoxha, duke u fokusuar në reformat e planifikuara por që nuk janë realizuar në administratë, bujqësi, transport rrugor etj.

Synohet themelimi i 'Air Kosova'

Prishtinë, 5 mars - Republika e Kosovës së shpejti do të promovojë politika për thirrjen e investitorëve të interesuar që të investojnë në tregun e transportit ajror, thonë zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, për faktin se shteti i Kosovës, sipas tyre, ende nuk ka ndonjë kompani shtetërore ajrore.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se së shpejti kjo ministri do të dërgojë një propozim në Qeverinë e Kosovës me qëllim të përgatitjes së dokumentacionit për fillimin e bashkëpunimit me kompani të interesuara për tregun e transportit ajror. "Ne si ministri, në konsultim me Agjencinë e Aviacionit Civil të Kosovës, do të promovojmë një politikë të nxitjes së investimeve të avio-kompanive të interesuara të cilat dëshirojnë të hyjnë në tregun e Kosovës në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës", ka thënë Lekaj.

Ministri Lekaj ka theksuar se Kosova po synon ta praktikojë modelin tashmë të zbatuar nga Republika e Shqipërisë.

Qeveria e Shqipërisë në muajin maj të vit të kaluar ka marrë vendim për krijimin e shoqërisë së përbashkët me përgjegjësi të kufizuar "Air Albania", e cila do të operojë në fushën e transportit ajror. Kjo kompani është krijuar ndërmjet disa ortakëve, por që në përputhje me ligjet shqiptare, shteti si pronar, përfaqëson 51 për qind të aksioneve. Vitet e fundit, nënvizoi ministri Lekaj, ka rënë trendi i krijimit të avio-kompanive shtetërore për shkak të kostos shumë të lartë dhe jo të qëndrueshmërisë së tyre financiare.

Edhe ekspertë të aviacionit civil vlerësojnë se situata financiare në Kosovë nuk është në favor të posedimit të kompanive ajrore.

Ali Aliu, piloti i parë kosovar që ka drejtuar aeroplanët reaktivë dhe supersonikë në ish-Armatën Popullore të ish-Jugosllavisë, thotë se ky biznes është shumë i shtrenjtë. Aliu, i cili ka qenë drejtor i Departamentit të Aviacionit në Ministrinë e Infrastrukturës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se duke marrë parasysh numrin e banorëve në Kosovë, shteti i Kosovës nuk ka leverdi për krijimin e një kompanie ajrore shtetërore për shkak të konkurrencës dhe kostos së lartë të mirëmbajtjes. "Më e leverdishme është që në këtë treg të jenë investitorë të huaj në mënyrë që mos të marrë barrën shteti për krijimin e një kompanie shtetërore ajrore. Kështu që unë jam për mundësinë që të ketë investitorë të huaj, kurse shteti të marrë pjesë me një përqindje të madhe të aksioneve, por jo të krijojë vetë sepse nuk ka llogari. Pra, ngjashëm sikurse që është në Shqipëri", ka thënë Aliu.

Aktualisht Kosova nuk është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, agjenci kjo e Kombeve të Bashkuara për Aviacion Civil.

Por, ministri Lekaj thotë se mosanëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë nuk paraqet ndonjë problem. "Në këtë drejtim nuk do të ketë probleme sepse ato (kompaninë e interesuara) janë nga shtetet e pranuara në këtë organizatë dhe ne vetëm bëjmë marrëveshje reciproke që ato të kenë simbolin e shtetit të Kosovës", ka theksuar Lekaj.

Në Kosovë ekziston Ligji i aviacionit publik i miratuar nga Kuvendi. Në këtë ligj thuhet se përdorimi i hapësirës ajrore të Kosovës është i lirë për të gjithë avionët civilë të regjistruar në Kosovë, por që duhet ta mbajnë markën shtetërore e cila i është ndarë Kosovës nga ana e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" gjatë vitit 2018 kanë operuar 32 kompani të gjitha ndërkombëtare. Shumica e tyre vijnë nga shtetet e Bashkimit Evropian. Zyrtarë të këtij aeroporti kanë thënë se gjatë vitit 2018 numri i pasagjerëve ka qenë mbi 2.1 milionë udhëtarë, apo 15 për qind më shumë se në vitin 2017.

Haradinaj zotohet për trajtim dinjitoz të shoqatave të dala nga lufta

Prishtinë, 5 mars - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim shoqatat e dala nga lufta, Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve si dhe Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Ai në këtë takim ka ritheksuar zotimin e Qeverisë së vendit për trajtim dinjitoz të kategorive të luftës. "Në këtë rrugë do të ecim me kujdes për t'i ruajtur vlerat e lirisë përmes ligjit!", ka thënë

Bytyqi priti në takim ambasadorin e ri të Turqisë, flasin për bashkëpunimin në arsim

Prishtinë, 5 mars - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të martën në takim ambasadorin e ri të Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, me të cilin ka biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit në arsim mes dy vendeve. Ministri Bytyqi fillimisht e ka uruar ambasadorin Sakar për detyrën e re dhe ka falënderuar shtetin turk për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës në të gjitha fushat e jetës, e veçanërisht në arsim.

Ministri Bytyqi ka theksuar bashkëpunimin e mirë që ka pasur edhe me ish-ambasadoren Kilic, duke shprehur gatishmërinë që ky bashkëpunim të thellohet edhe më tutje në të mirë të ofrimit të arsimit cilësor për nxënësit dhe studentët.

Ambasadori Çagri Sakar ka falënderuar ministrin Bytyqi për gatishmërinë për bashkëpunim dhe ka theksuar se është i gatshëm t'i vazhdojë projektet e rëndësishme në arsim, ndërsa ka thënë se i jep kënaqësi fakti që bashkatdhetarët e tij që jetojnë në Kosovë kanë mundësi të arsimohen në gjuhën turke.

Veseli: Orientimi im është te njerëzit ndërmarrës dhe novatorë

Qendresa RAMA

GJILAN, 5 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, ka vizituar të martën një prej bizneseve më të mëdha prodhuese, fabrikën e mobileve "Palma" në Gjilan, e cila shumicën e produkteve i eksporton në vendet e Bashkimit Evropian. Veseli ka thënë se fabrika "Palma" është shembull i suksesit, i ndërmarrësisë, i punës dhe shtetit. "Kosova ka patriotë, ka shtet, ka sovranitetin dhe integritetin e vet. Asaj aktualisht i mungon ndërmarrësia e fuqishme. Por, njerëz si Ekremi janë duke na dhënë shembull se Kosova ka shpirt ndërmarrësie, ka mundësi dhe potencial të jashtëzakonshëm të zhvillimit. Orientimi im është te njerëzit ndërmarrës dhe inovatorë", ka theksuar kryeparlamentari Veseli. Ai ka shtuar se ky do të jetë orientimi i institucioneve të Kosovës, i cili, sipas tij, do të thotë mmbrojtje e sovranitetit dhe integritetit, do të thotë fuqizim i Ushtrisë së Kosovës. "Me njerëz të tillë të fuqishëm ndërmarrës mund të zhvillohet dhe fuqizohet Kosova, e jo me fjalë. Ajo çfarë na duhet është mbështetja dhe fuqizimi i kompanive si 'Palma', 'Bini' e të tjera", është shprehur Veseli. Kryeparlamentari Veseli ka pohuar se lehtësirat fiskale, të ndërmarra nga Ministria e Financave, do të vazhdojnë edhe më të tutje. Pronari i fabrikës "Palma", Ekrem Shahini, duke falënderuar kryetarin Veseli dhe ministrin Hamza për vizitën dhe mbështetjen e tyre, ka theksuar se pakot fiskale kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë prodhuese, duke lehtësuar bërjen e të bërit biznes dhe modernizimin e makinerisë së punës.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se mbështetja ndaj bizneseve do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me theks të veçantë ndaj atyre që eksportojnë produktet. "Kemi qenë të vetëdijshëm dhe jemi të lumtur që të gjitha masat që i kemi ndërmarrë do të kenë efekt negativ në buxhet në aspektin afatshkurtër, por në aspektin afatgjatë, do të kenë ndikim pozitiv. Dhe kështu ka ndodhur", ka deklaruar ministri Hamza.

Ndahen 100 mijë euro për themelimin e Qendrës Përkujtimore për gjenocidin mbi shqiptarët 'Bllaca 1999'

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 MARS - Në përkujtim të "Epopesë së UÇK-së" dhe rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes së tij, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka filluar mbledhjen e së martës me një minutë heshtje dhe nderim për sakrificën e familjes Jashari dhe të gjithë atyre që ranë në luftën për liri. Kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga të gjithë resorët qeveritarë dhe institucionalë përmbushjen e obligimeve dhe të angazhimeve në favor të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë 40 mijë euro për ta përmbushur kontributin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2019 në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë. Republika e Kosovës bën pjesë në grupin prej katër përqindësh të shumës totale të vendeve të Evropës Juglindore që është përcaktuar formalisht në Samitin e Bukureshtit në nëntor të vitit 2006.

Në mbledhjen e kabinetit qeveritar ka miratuar plotësim-ndryshimin e vendimit për themelimin e Qendrës Përkujtimore për gjenocidin mbi shqiptarët "Bllaca 1999". Me plotësim-ndryshimin e vendimit ndahen 100 mijë euro për realizimin e këtij projekti.

Me vendimin që ka miratuar të martën Qeveria, është autorizuar ministri i Financave të aprovojë transferime nga nënprogrami "Shpenzimet e paparashikuara" në shuma individuale deri në shumën prej 40 mijë eurove për vitin 2019 të ndarjeve buxhetore.

Nisma për lidhjen e "Marrëveshjes për punën fitimprurëse të anëtarëve të familjeve të anëtarëve të një misioni diplomatik apo konsullor" me Republikën e Francës ka marrë miratimin në parim në mbledhjen e Qeverisë.

Edhe nisma për nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Tajlandës për mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve ka marrë mbështetjen në parim nga kabineti qeveritar. Në mbledhjen e së martës Qeveria ka aprovuar në parim nismën për anëtarësim si "Anëtar i asociuar" në Zyrën Ndërkombëtare të Peshave dhe Matjeve.

Miratimin në parim e ka marrë edhe marrëveshja ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me

tatimin në të hyra dhe kapital, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Portugalisë.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka prezantuar idenë për organizimin e një takimi të kryeministrave të vendeve të rajonit për të diskutuar procesin e integrimit të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian dhe në të cilin do të ftoheshin edhe përfaqësues nga Komisioni Evropian.

Kryeministri ka kërkuar informata për zbatimin e Ligjit të Prokurimit nga Ministria e Financave për përfshirjen e komuniteteve pakicë në Policinë e Kosovës si dhe kërkesat e shoqatave të dala nga lufta.

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka kërkuar angazhimin e ministrive të veçanta në procesin e realizimit të marrëveshjeve të arritura nga mbledhjet e përbashkëta të Qeverisë së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

LLUKA NË KANADA PËR TË SJELLË INVESTITORË NË SEKTORIN MINERAR

EPOKA E RE A. MAVRAJ

Prishtinë, 5 mars - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, i shoqëruar nga deputetja Sala Berisha-Shala dhe kryetari i Bordit të "Trepçës", Ardian Syla, po qëndrojnë për një vizitë treditore në Toronto të Kanadasë për të marrë pjesë në konferencën vjetore të minierave dhe mineraleve, PDAC. Kjo konferencë bashkon politikën, organizatat dhe bizneset me qëllim të tërheqjes së investimeve në këtë fushë. Në ditën e parë të kësaj vizite, ministri Lluka, së bashku me delegacionin e Kosovës, ka takuar kryetarin e Odës Ekonomike të Ontarios, Rocco Rossi, të cilin e ka njoftuar nga afër për të gjitha ndryshimet ligjore që kanë ndodhur gjatë vitit 2018, duke përfshirë edhe statutin e "Trepçës". Oda Ekonomike e Ontarios do të ndihmojë promovimin e projekteve minerare në Kosovë tek kompanitë kanadeze.

Ngjarja më e rëndësishme e ditës ishte samiti ndërministror, organizuar nën përkujdesjen e ministrit të Burimeve Natyrore të Kanadasë, Amarjeet Sohi, ku mbi 30 ministra dhe liderë të fushës së energjisë dhe minierave morën pjesë për të diskutuar rreth politikave zhvillimore të këtij sektori, duke biseduar për trendët e sektorit minerar që parashihet të ketë një zhvillim jashtëzakonisht të madh, duke vlerësuar që panelet solare, turbinat me erë, bateritë për deponim të energjisë, makinat elektrike dhe elektrifikimi i ekonomisë në përgjithësi përdorin minerale të ndryshme që pritet ta rrisin eksploatimin për mbi 1 000 për qind.

Gjithashtu, u shkëmbyen praktikat më të mira në zhvillimin e sektorit minerar, njëkohësisht e mbyllëm tregun e bursës se minierave të Torontos.

Ministri Lluka në ceremoninë e hapjes së PDAC 2019 ka zhvilluar një takim edhe me presidentin e saj Glenn Mullan, të cilin e ka njoftuar për potencialin që ofron Kosova në sektorin minerar. Gjithashtu, Lluka gjatë kësaj vizite do të takojë edhe disa prej kompanive kanadeze siç janë Avrupa edhe Trevali të cilat tashmë vetëm se kanë filluar investimet në sektorin minerar në vendin tonë. Në këtë drejtim Lluka do ta takojë edhe rrjetin e bizneseve shqiptare në Kanada.

KDI-JA: KONKURRENCA JOLOJALE DHE MUNGESA E MBËSHTETJES INSTITUCIONALE SFIDON BUJQIT

Prishtinë, 5 mars (ER) - Bujqit kosovarë vazhdojnë të përballen me probleme të shumta pavarësisht se bujqësia në Kosovë llogaritet sektor shumë i rëndësishëm. Cilësia e dobët e farërave që importohet nga vendet e rajonit, mungesa e një tregu të sigurt për shitjen e produkteve bujqësore dhe mospërkrahja e mjaftueshme nga niveli qendror dhe ai lokal, janë disa prej problemeve që i shqetëson bujqit kosovarë.

Me të njëjtat probleme përballen edhe bujqit e Klinës.

Në një takim të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës bujqit e Klinës shprehen shqetësimet e tyre dhe vështirësitë me të cilat ata po përballen.

Ilaz Selimi, i cili merret me prodhimin e farërave, theksoi se prodhuesit vendorë po dëmtohen nga konkurrenca jo e drejtë si dhe po dëmtohen me farërat që importohen nga shtetet e tjera, sidomos nga Serbia. Ai ka theksuar se janë pesë varietete të farërave që hyjnë në Kosovë nga Serbia dhe se janë false pasi nuk prodhohen aty.

Sejdi Baleci, një fermer tjetër, ka thënë se fabrikat, siç janë ato të prodhimeve të qumështit, nuk bashkëpunojnë me fermerët vendorë dhe po synojnë që me çmime shumë të ulëta t'i marrin prodhimet e tyre.

Një treg për shitjen e produkteve si dhe një vend për ruajtjen e pemëve ishin në mesin e kërkesave që fermerët shprehen para zyrtarëve komunalë.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Komunën e Klinës, Naser Morina, ka thënë se komuna me aq sa ka pasur mundësi ka ndihmuar deri tani bujqit, duke pranuar se ka ende punë për të bërë. "Me një planprogram që kemi për vitin 2019 disa investime

që do t'i kemi janë: kanalet e ujitjes, disa sera dhe më e rëndësishmja, krijimi i një fondi emergjent", është shprehur Morina, duke kërkuar nga bujqit të jenë më aktivë rreth kërkesave të tyre dhe të marrin pjesë në thirrjet e komunës për subvencionim.

Komuna e Klinës për vitin 2019 ka ndarë 85 mijë euro për investime kapitale në bujqësi dhe rreth 45 mijë euro për subvencione. Ky takim është organizuar në kuadër të projektit "Rritja e llogaridhënës së institucioneve lokale në Kosovë", i cili financohet nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë.

AMBASADORI KOSNETT THOTË SE TREGTIA E PAPENGUAR RAJONALE NDIKON NË TËRHEQJEN E INVESTIMEVE

Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 5 mars - Sundimi më i fuqishëm i ligjit, një ekonomi më funksionale e tregut si dhe tregtia e papenguar rajonale përbëjnë shtegun e Kosovës për tërheqjen e investimeve amerikane dhe investimeve të tjera të huaja. Këto ishin konkluzionet e takimit të ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip S. Kosnett, me udhëheqësinë e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Ambasadori Kosnett i ka thënë Bordit të Guvernatorëve dhe drejtorit ekzekutiv të Odës Amerikane, se Ambasada është e lumtur të dëgjojë se prioritetet e saj për paqe, drejtësi dhe prosperitet janë edhe prioritete të qytetarëve të Kosovës.

Ambasadori Kosnett ka theksuar se Ambasada e ShBA-së përkrah Odën Amerikane në adresimin e çështjeve të sipërcekura, si dhe në kultivimin e bashkëpunimit ndërkufitar me Odat e tjera Amerikane në Ballkanin Perëndimor.

Presidenti i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahimi, e ka informuar ambasadorin për prioritetet kyçe të bordit, të cilat përfshijnë adresimin e çështjeve të lidhura me pasigurinë politike, popullizmin ekonomik, fuqizimin ekonomik të gruas, masat që duhen ndërmarrë për tërheqjen e investimeve të huaja, sundimin e ligjit, korrupsionin dhe zbatimin e kontratave.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka folur rreth aktiviteteve të organizatës që synojnë adresimin e çështjeve të sipërcekura dhe përmirësimin e prospekteve të Kosovës për më shumë investime amerikane.

Anëtarët e Bordit të Guvernatorëve prezantuan aspektet që ata i konsiderojnë prioritete ekonomike për vendin, duke theksuar nevojën për më shumë dialog ndërmjet sektorit publik dhe privat. Pjesëmarrësit e takimit thanë se të gjitha çështjet me të cilat përballen investitorët e huaj dhe sektori privat në përgjithësi duhen zgjidhur përmes dialogut ndërmjet përfaqësuesve të sektorit publik dhe privat.

SHALA KËRKON QË BIZNESET TË BËHEN PJESË E HARTIMIT TË LIGJIT PËR TREGTI TË BRENDSHME

Prishtinë, 5 mars - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka zhvilluar një takim me prodhuesit vendorë së bashku me kryetarin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, me të cilët ka diskutuar për çështjet e të bërit biznes në Kosovë. Ai ka kërkuar që bizneset të bëhen pjesë e hartimit të Ligjit për tregti të brendshme. "Bashkëbisedova me prodhues vendorë bashkë me kryetarin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka dhe u ngritën shumë çështje në lidhje me të bërit biznes. Bizneset i sigurova se do të jem përkrah tyre, duke iu kërkuar të bëhen pjesë e hartimit të Ligjit për Tregti të Brendshme. Po ashtu, më informuan se kanë rritur prodhimin, shitjen dhe numrin e punëtorëve në muajt e fundit. Ky fakt më gëzon shumë sepse detyrë dhe mision imi është fuqizimi i bizneseve dhe rritja e prodhimit vendor", ka thënë ministri Shala.

Më 12 mars mbahet ankandi i katërt i letrave me vlerë për vitin 2019

Prishtinë, 5 mars - Ministria e Financave ka njoftuar se më 12 mars të këtij viti do të mbahet ankandi i katërt me radhë për vitin 2019. Në këtë ankand do të emetohen Bono Thesari me maturitet dymbëdhjetëmujor në shumën prej 30 milionë eurosh. "Investimi në Bono Thesari është investim i sigurt i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (12 muaj) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Financave, e cila ka theksuar se për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohet ndonjëra prej bankave komerciale që operojnë në Kosovë.

Fushë-Kosova së shpejti me furnizim 24 orë me ujë

Fushë-Kosovë, 5 mars - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar konsumatorët e qytetit të Fushë-Kosovës se ka filluar ekzekutimi i punimeve në vendosjen e tubit i cili shumë shpejtë do t'i furnizojë me ujë të pijshëm 24 orë pa ndërprerë. Kryeshefi ekzekutiv i Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal "Prishtina", Ilir Abdullahu, zëvendëskryeshefi Kujtim Xhelili dhe shefi i Njësisë Operative të Fushë-Kosovës, Remzi Llumnica, kanë vizituar për së afërmi punimet që po zhvillohen atje. Abdullahu ka thënë se ndihet i gëzuar që më në fund edhe konsumatorët e Fushë-Kosovës do të kenë ujë të pijshëm pa ndërprerë. Ai pret nga konsumatorët që në të ardhmen të bëjnë pagesa të rregullta për shërbimet e ofruara dhe shpenzim racional të ujit të pijshëm. "Tubi është me diametër fi 630 mm dhe me një gjatësi prej 2.2. km, ku uji fillestar do të merret nga fabrika e trajtimit të ujit në 'Shkabaj'. Punëkryesi i këtij projekti është kompania 'Alfa', e cila përgjatë një muaji ka bërë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme teknike në rezervuarin e Shkabajve, ndërsa sot ka filluar vendosjen e tubave", ka thënë Abdullahu. Kostoja financiare e këtij projekti ka vlerën 378 mijë euro. Projekti pritet të përfundojë në fund të muajit prill të këtij viti.

Gjendet trupi i një 12-vjeçari gjatë gërmimeve në Zallq të Istogut

Istog, 5 mars - Në fshatin Zallq të Komunës së Istogut është gjetur një trup i moshës 12-vjeçare gjatë gërmimeve për persona të zhdukur gjatë luftës. Lajmin e ka konfirmuar edhe kryetari i Komisionit Qeveritar për të Pagjeturit, Prenk Gjetaj. "Sipas ekspertëve, trupi i përket një 12-vjeçari i cili ishte i mbështjellë me një batanije dhe kishte të mbathura një palë çorape. Identiteti i tij ende nuk dihet dhe po pritet të bëhen analiza", u shpreh Gjetaj. Ai ka bërë me dije se gërmimet për të zhdukurit në këtë lokalitet kanë përfunduar.

KEDS-i vendos gjashtë trafo të reja në Obranq të Podujevës

Podujevë, 5 mars - Tashmë mbi 230 familje të këtij fshati kanë shërbime shumë më kualitative dhe më të sigurta pasi KEDS-i ka vendosur rrjetin komplet të ri, me shtylla betoni. Ekipet e KEDS-it kanë kryer punimet në projektin investiv Obranqa 1/2 në Podujevë, që përfshin komplet fshatin. Kështu thuhet në njoftimin e KEDS-it. "Këtu janë vendosur gjashtë trafo të reja. Tri me fuqi 250 kVA dhe tri trafo me 160 kVA dhe një është riparuar. Me këtë investim banorët, përveçse do të kenë energji kualitative dhe tension stabil, për ta është larguar edhe rreziku tërësisht nga shtyllat e vjetra, pasi që ato janë zëvendësuar me shtylla betoni. Fshati Obranq ka një terren të hapur dhe shtëpi të shpërndara dhe me realizimin e këtij projekti KEDS-i ka bërë që secila shtëpi të ketë energji kualitative dhe rrjet të ri. Janë mbi 230 familje që po përfitojnë nga ky investim", është thënë në një komunikatë për medie të KEDS-it.

Në Ferizaj hapet Qendra e Kujdesit për Fëmijët e Margjinalizuar

Ferizaj, 5 mars - Në Ferizaj është hapur Qendra e Kujdesit Ditor për Fëmijët e Margjinalizuar dhe ata që nuk e kanë një kujdes të duhur familjar. Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Ferizajt, Bekim Ademi, ka thënë se ky projekt me vlera humane meriton të përkrahet në mënyrën më të mirë dhe mbështetja do të vazhdojë edhe më tutje.

Flutura Nuha, koordinatore në këtë qendër, ka pohuar se në këtë formë është menduar që këtu ta gjejnë kujdesin e nevojshëm për rreth 35 fëmijë të moshave nga 6 e deri në 15 vjeç që deri më tani nuk e kanë pasur kujdesin e duhur në shoqëri. Projekti i qendrës ditore për një kujdes më të mirë të fëmijëve me nevoja më të veçanta është një bashkëpunim në mes të organizatës në SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, Komunës së Ferizajt dhe organizatës gjermane GIZ.

Kurse donatorët nga organizata gjermane GIZ kanë thënë se për disa muaj do të vazhdojnë ta përkrahin funksionimin e qendrës, ndërsa nuk do të mungojnë edhe projektet e natyrave të tjera. Në qendrën e hapur sot rastet e fëmijëve në nevojë mund të referohen nga qendra për punë sociale, shkollat dhe organizata joqeveritare, ndërsa në atë do të punojnë punëtorë socialë, pedagogë dhe psikologë.

Psikologja e qendrës, Qamile Stublla, ka thënë se përmes seancave grupore e individuale pret që fëmijët e margjinalizuar të jenë më mirë të trajtuar.

Qendra për kujdesin ditor të fëmijëve të grupmoshave të ndryshme të cilët kanë nevoja shkollore, sociale e të një kujdesi më të mirë familjar është qendra e parë e cila është hapur në Kosovë. Ndërsa ajo pritet të vazhdojë të funksionojë në bazë të përkrahjes që do t'i ofrojë Komuna e Ferizajt dhe organizatat e tjera joqeveritare që merren me të drejtat e fëmijëve.

Rrëfimi im për 5 marsin 1998

Shkruan: Blerim LATIFI

Të gjithë ishim në gjumë. Aty rreth orës pesë të mëngjesit në dyert e oborrit u dëgjua një e trokitur e fortë. U vesha shpejt dhe dola në oborr. Baba erdhi i shqetësuar nga takimi me njeriun që trokiti. Na tregoi se ishte Zymeri i Qazimit, një kushëri yni. Zymeri kishte lajmëruar se në Ternavc, fshat ky në veri të Prekazit, ishin grumbulluar forca të mëdha policore. Një pjesë e tyre kishin hyrë në rrugën e Prekazit.

Kaq mjaftonte që të besonim se këto forca kishin për cak arritjen te shkolla e Prekazit. Nëse kjo do të ndodhte, atëherë lagjja jonë praktikisht do të vendosej nën rrethim. Baba urdhëroi: "Çohuni e bahuni gati, që mos ta na zanë në gjumë". U ngritën të gjithë, duke pasur në mendje atë që kishte ndodhur në Qirez e Likoshan pak ditë më parë. Trishtimi ishte i madh.

Nuk vonoi dhe u dëgjua një zhurmë e madhe. Ishin tanket që po lëviznin nga Ternavci drejt Skenderajt. Nata ende nuk kishte kaluar dhe në qetësinë e saj zhurma që bënin tanket ishte edhe më e frikshme. Askush nuk e dinte çfarë po ndodhte. Në sokak ishin grumbulluar njerëzit e lagjes.

Qysh nga vjeshta e vitit 1997, në objektin e ish Fabrikës së Municionit, kishte pasur koncentrim të njësive policore serbe, dhe dikush, që ju kujtua kjo gjë, dha mendimin se ndoshta kjo lëvizje tankesh ka të bëjë me ndonjë zëvendësim njësish. Ah, sikur të ishte kështu! Kush e dinte vallë të vërtetën në ato momente?

Në pjesën e poshtme të Prekazit, nuk lëvizte gjë. Për pak kohë, zhurma e tankeve u ndërpre. Si duket kishin arritur në Skenderaj. Qetësia u prish nga disa rafalë armësh që u dëgjuan në kodrën mbi Skenderaj, e cila ndan qytetin nga fshati i Llaushës. Menduam se po sulmonin në Llaushë. Aty kishte pasur zhvillime dramatike që nga nëntori i vitit 1997. Kishte ndodhur një konfrontim i armatosur në mes të një grupi të UÇK-së dhe policisë serbe. Një ditë pas kësaj, në varrimin e mësuesit Halit Geci, që u vra nga policia ditën e konfrontimit, u shfaqën publikisht tre pjesëtarë të uniformuar të UÇK-së.

Kujtimi i këtyre ngjarjeve na bëri të mendojmë se tani serbët ishin kthyer për t'u hakmarrë. Pastaj, u dëgjuan dy të shtëna pushke. Ato ishin shumë më afër se të parat. Dikush tha se këto vinin nga pjesa që ndan Prekazin dhe Klinën e Ulët. Çfarë ishte duke ndodhur?

Nuk mund të kenë kaluar më shumë se dhjetë minuta kur pamë një grumbull të madh burrash, grash e fëmijësh të lagjes së Dushkajës që po iknin të tmerruar arave në drejtim të lagjes sonë. Gjërat filluan të qartësoheshin. Policia serbe po hynte në Prekaz. Atëherë, dikush tërhoqi vëmendjen nga Lagjja Jashari. Nëpër rrugën që shpie nga Skenderaj, në drejtim të kësaj lagjeje, dukeshin mjete të blinduara ushtarake. Misteri i të gjitha atyre lëvizjeve, që nuk po i lidhnim dot, tani u zbardh për ne. Po rrethohej Lagjja Jashari.

Duhet të ketë qenë ora 6:30 e mëngjesit kur nisën të shtënat. Ishte një shkëmbim zjarri që veç në filma e kisha parë. Tashmë ishte bërë ditë dhe gjithçka dukej qartë. Kishte filluar një sulm masiv mbi kompleksin e shtëpive të Adem Jasharit. Si dukej policia kishte vënë në zbatim një operacion të neutralizimit të shpejtë të objektivit, por kishin hasur në rezistencë të fortë brenda shtëpive të sulmuara.

Ky shkëmbim zjarri nuk zgjati më tepër se gjysmë ore, kur çfarë të shohim - nisi një granatim masiv i shtëpive. Kishte filluar si duket Plani B: bombardimi me artileri i objektivit. Brenda dy-tre orësh gjithçka u mbulua nga tymi i shtëpive që kishin marrë flakë. Deri në mesditë, siç na tregoi një kushëri që i kishte numëruar, mbi shtëpitë e Adem Jasharit dhe shtëpitë tjera të Lagjes Jashari, ishin hedhur 125 predha artilerie. Gjithçka ishte përtej imagjinatës. Një ushtri me artileri të rëndë ishte hedhur në sulm kundër një familjeje të vetme. Rrëfimi biblik i ndeshjes së Davidit me Goliatin është i varfër në krahasim me atë që po ndodhte atë ditë në Prekaz.

Gjatë asaj kohe, gratë dhe fëmijët e lagjeve tjera u larguan në drejtim të Mikushnicës e Lubovecit. Me disa kushërinj të mi u nisa në drejtim të shkollës së Prekazit. Në afërsi të saj, në Malin e Mikushnicës, ishin grumbulluar një grup njerëzish. Disa prej tyre ishin të armatosur. Bisedonin që ta sulmonin policinë nga drejtimi i Lagjes së Dushkajes, por çfarë mund të bënin realisht me ato tre-katër armë dhe atë pak municion që kishin!? Dikush thoshte se duhej thirrur secili që ka ndonjë armë, e dikush se ndoshta njerëzit e UÇK-së, të shpërndarë nëpër fshatra, janë duke ardhur në ndihmë, e ndonjë tjetër evidentonte faktin se Prekazi është një territor i hapur e pa pyje dhe kjo e bënte të parealizueshme idenë për t'iu afruar vijës së rrethimit, për ta goditur më pas. Dy burra të fshatit Duboc, që kishin provuar këtë gjë, ishin goditur që larg nga policia. Njëri prej tyre,vdiq në vend. Tjetri, me plagë të mëdha, ia doli të tërhiqej me të rënë nata.

Në orët e para pas mesditës, erdhën të gjallët e parë nga Lagjja Jashari. Në mesin e tyre ishte një djalë i plagosur rëndë. Quhej Riad. Vëllai im Xhevdeti, mjek me profesion, ia dha ndihmën e parë, aty në Malin e Mikushnicës. I plagosuri ishte në gjendje shoku. Mes dhimbjeve të tmerrshme që po ia shkatërronin trupin, tregonte se si policia kishte hyrë nëpër shtëpi duke ekzekutuar secilin që haste. Prej tij kuptuam emrat e parë të të vrarëve në Lagjen Jashari.

Orët po kalonin ngadalë, tmerrësisht ngadalë, ngase të gjithë e prisnim me padurim natën. Mendonim se bashkë me natën do të vijnë edhe shpëtimtarët. A nuk kishte thënë dikur Azem Bejta, prijësi legjendar i kaçakëve, se "dita është e hyqymetit, e nata është e jona". Të gjithë e besonim vetëm një gjë: Ademi është gjallë dhe me të rënë nata do dalë nga rrethimi. Njësoj si heronjtë e legjendave dhe këngëve të vjetra epike. Nata erdhi dhe dëshirat e njerëzve morën krahët e imagjinatës dhe spekulimeve. Flitej se Ademi kishte dalë nga rrethimi. Flitej se e kishin parë në Mikushnicë. Flitej se ishte i plagosur, por ndodhej jashtë rrethimit. Flitej e çfarë nuk flitej, vetëm vdekjen e tij askush s'e mendonte. Legjenda për të kishte marrë udhë. Një komb i tërë do të ngrihej në këmbë prej saj. Frika nga vdekja ishte mposhtur. Dhe, me këtë, siç do të thoshte Hegeli, tirani e kishte humbur betejën e parë me të shtypurin.

Gjobat nuk pakësojnë vdekjet nga aksidentet në trafik

Prishtinë, 5 mars - Shtatë persona kanë vdekur vetëm gjatë muajit janar të këtij viti në aksidente komunikacioni ose një më shumë sesa në vitin e kaluar në po të njëjtin muaj. Por, sipas policisë, gjatë muajit janar ka pasur 645 persona të lënduar nga 972 sa kishte në janar të vitit të kaluar.

Baki Kelani, zëdhënës në Policinë e Kosovës, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se, referuar statistikave për këtë periudhë kohore, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ka rënie të aksidenteve në përgjithësi, por humbja e vetëm edhe një jete mbetet shqetësuese. Ai ka shtuar se një ndër prioritetet e Policisë së Kosovës është bashkëpunimi në nivel të ministrive përkatëse si dhe niveleve komunale me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe ndërmarrjes së veprimeve konkrete edhe për vendosjen e kamerave statike të cilat do të ndikonin në ngritjen e sigurisë në trafik.

"Policia në kuadër të përgjegjësive të veta, përveç aktiviteteve të tjera, ka formuar edhe Task-Forcën për parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor dhe plani veprues dhe parandalues i kësaj Task Force ka paraparë edhe përfshirjen, koordinimin dhe bashkërendimin e njësiteve të ndryshme në terren, në pika kontrolli, akse rrugore, si dhe aplikimin e metodave të ndryshme të avancuara nga njësitet policore, për arritjen e parandalimit të aksidenteve në tërësi, në veçanti të atyre me pasoja fatale, të cilat, së bashku me ndryshimet në ligj, kanë dhënë efekt pozitiv", ka thënë Kelani.

Në janar të vitit të kaluar në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji i ri për shkelësit në komunikacion, i cili parasheh dënime nga 300 deri në 900 euro si dhe marrja e pikëve nga patentshoferët për ngasësit problematikë.

Vetëm gjatë muajit janar policia ka shqiptuar 30 mijë

dënime.

Basri Lenjani, drejtor i Klinikës Emergjente brenda Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ka bërë me dije se klinika e tij është ballafaquar me një numër të madh të të lënduarve në komunikacion. Përkundër kësaj, siç thotë Lenjani, Klinika Emergjente ka ofruar shërbime për mbështetje bazike, por edhe për ato të avancuara të shërbimeve mjekësore. "Gjatë këtij viti kemi dy të vdekur në Klinikë për shkak të lëndimeve që kanë marrë si pasojë e aksidenteve. Shpeshherë mund të qëndrojnë rastet e lënduara në pritje për shkak të pamundësisë për t'i trajtuar të gjithë përnjëherësh", ka thënë Lenjani.

Ekspertët e komunikacionit e vlerësojnë situatën mjaft shqetësuese pasi, sipas tyre, ndër arsyet e shtimit të numrit të aksidenteve është mosrespektimi i shenjave të komunikacionit. "Problemi qëndron te ngasësit e automjeteve të cilët nuk respektojnë kodin rrugor dhe shenjat e trafikut. Vitin e kaluar është ngritur Njësiti i Task-Forcës, i cili ka dhënë rekomandime se çfarë duhet të ndërmerret në mënyrë që të ngrihet siguria në rrugë. Rezultatet priten gjatë këtij viti nga institucionet të cilat kanë mandat për sigurinë në rrugë, në mënyrë që të rritet siguria në rrugë. Ky numër i lartë i aksidenteve mbetet si rezultat i papërgjegjësisë së ngasësve duke mos respektuar shenjat, sidomos shpejtësinë në rrugë jo konform rregullave të komunikacionit", ka thënë Muhamet Krasniqi, ekspert për komunikacion.

Sipas Krasniqit, edhe përdorimi i telefonave gjatë vozitjes është një nga faktorët që ul sigurinë e gjithë pjesëmarrësve në komunikacion. Në vitin 2018 kanë vdekur 128 persona në aksidente trafiku nga 137 të vdekur që ishin në vitin 2017.

‘Libri i luftës’, sirtar i arkivit të luftës

Muhamet MAVRAJ,
redaktor i librit

Të tjerët mund të mos e besojnë por, ne shqiptarët, për disa çaste pikante të rrjedhës historike nuk kemi as faktografi të plotë, as gjysmëfotografi. Edhe pse teknika ishte zbuluar shumë dekada më përpara, kurrë s'kemi pasur fotografi të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912, asnjë pamje brenda mbledhjes gjithëkombëtare, as momentin e ngritjes së flamurit kombëtar. Plot ngjarje pasuese dramatike janë sikur të mos kishin ndodhur kurrë. Fuqinë e fotografisë nuk e mposhtë lehtë as përshkrimi më i saktë.

Në fund të shekullit, kur Kosova u ripushtua nga Serbia në termat më të ashpër të pushtimit, pas autonomisë së rrënuar, pasoja e parë ishte nata e gjatë informative. Një hapësirë e ngushtë informimi prej vitit 1990 deri më 1997 ra në dorë të re të monopolit. E vërteta u monopolizua sërish. Brenda Prishtinës dhe jashtë saj, tjetra e vërtetë shqiptare, opozitarja, do të vonohej ose do të deformohej rëndë sikur të mos kishim një grup gazetarësh që gjejnë gjithmonë mënyra për të thyer monopole. Një prej tyre, Nuhi Bytyçi, shfaqet në kohën dhe vendin e duhur edhe më 1997. Po bëheshin shtatë vjet që Kosova kllapitej e topitej nga iluzionet e fitores paqësore kundër Serbisë, thjesht duke shmangur çdo lloj protestimi dhe duke paguar taksa për shtetin serb. Katër njësi ish-jugosllave tashmë ishin bërë shtete të pavarura, ndërsa katër të tjera mbajtën qendrën në Beograd. Në të vërtetë dy, Serbia dhe Mali i Zi, sepse Kosova dhe Vojvodina ishin vetëm nocione gjeografike brenda Serbisë. Kosova nuk u ftua në Konferencën e Dejtonit në dhjetor të vitit 1995 dhe kështu e pa veten të mashtruar jo nga tjerët, por nga vetvetja. Për sa i përket informimit të opinionit publik, dyvjetëshi dhjetor 1995-shtator 1997 është ndër më agresivët kundër të vërtetës: Prishtina dhe Tirana zyrtare prodhonin vetëm propagandë. Zëri ndryshe ishte zë i dyshimtë. Ndërkohë që Shqipëria u mbyt në luftë civile si pasojë e propagandës vetëshkatërruese, Kosova vuajti një dimër të tmerrshëm dyfish: sa për Shqipërinë, aq për veten. Universiteti i Prishtinës, i vetmi i shqiptarëve të Kosovës, ndonëse vetë në pozitë të rëndë nëpër shtëpi private të Prishtinës, i shpërndarë sa në një periferi në tjetrën, sërish e mori mbi vete barrën e rëndë të artikulimit të ndryshimit të kursit: dhënien fund të heshtjes dhe kalimin në rezistencë vepruese. Korrespondentët shqiptarë që raportonin nga Prishtina për radiot perëndimore me emisione sporadike në gjuhën shqipe kanë qenë një dritare dalëse e zërit studentor, sepse raportonin profesionalisht nga konferencat tona për media në fazën përgatitore në gusht dhe shtator 1997. Por, ato ishin vetëm zë. Krahas tyre, "Koha ditore" që po i bënte muajt e parë të jetës, dhe vetë gazetës sonë "Bota e re" shkërmoqën pak nga pak atë monopolin jodinjitoz të "Bujkut" e "Qendrës për Informim të Kosovës" dhe të disa periodikëve servilë të politikës së partisë më të madhe. Kur afrohet çasti i demonstratave të 1 tetorit 1997, kreu politik i Kosovës i komplikoi dhe manipuloi zhvillimet në atë mënyrë që, po të ndodhnin manifestime në rrugë, do të shkonte gjaku deri në gju. Gjithçka e ka fundin e vet. Ky instrument i frikës kishte vetëm edhe një natë jetë. Dy gazetarë, Nuhi Bytyçi dhe Qani Mehmedi, dhe një kameraman me ta, Jusuf Rizvanolli, me emisionin e tyre të transmetuar një natë para demonstratës së 1 tetorit në Televizionin Shqiptar, "Brezi i sakrificës dhe i ardhmërisë sonë", e bënë shpërfaqjen konkrete të qëndrimeve tona studentore dhe na ndihmuan t'ia japim dackën e fundit politikës së vëtëfrikësimit. Kjo politikë, më shumë sesa tanket serbe, ia ruanin qetësinë Serbisë në Kosovë deri atë natë. Kurrë më! Të nesërmen, më 1 tetor 1997, në Prishtinë dhe në gjashtë qendra të tjera të Kosovës ku kishim degë universitare, studentët e Kosovës dëshmuan se e pamundshmja është asgjë.

Kur shpërtheu edhe lufta e armatosur, më lehtë shkohej në Australi sesa në zonat e luftës. Shumë zhvillime dramatike kurrë nuk janë regjistruar, ndërsa ato që i shohim edhe sot nga betimi i ushtarëve tanë dhe paraqitjet e konsoliduara të Ushtrisë sonë Çlirimtare, si për shembull shfaqjen e parë të zëdhënësit, janë fryt i paçmueshëm përgjithmonë i Nuhi Bytyçit dhe kameramanit Abaz Zeka. Që t'i kishim këto nuk ishte kusht mundësia materiale, që ishte për keqardhje të thellë, por gazetaria e guximshme. Këta njerëz kanë rrezikuar kokat e tyre dhe familjet e tyre.

Para demonstratave, pas tyre, para luftës, gjatë luftës dhe më pas, e kam njohur Nuhiun dhe kam bashkëpunuar me të në përkrahje të pakusht dhe të parezervë, për luftën dhe kauzën tonë. Gjithmonë i kisha në mendje imazhet nga greva e minatorëve,



ku Nuhiu depërtonte me raportimet e tij televizive dhe padyshim pamjet e konfrontimit të tij me policët më 2 korrik 1990.

Shtatë vjet më vonë, tetë e nëntë, nuk isha vetëm lider studentor që bën demonstrata dhe jep deklarata të hapura për luftën e drejtë, ose vetëm lider që i mbush radhët e ushtrisë me studentë të besueshëm por, njëkohësisht, edhe kryeredaktor i gazetës "Bota e re". Që barra të jetë edhe më serioze, për të mos thënë skajshmërisht e rrezikshme për mua dhe ata djelmosha e ca vasha ta guximshme, njëkohësisht duhej mbushur me zhvillimet e fushëbetejave edhe faqet e "Zërit të Kosovës" në Perëndim, ku Adnan Asllani dhe Lulëzim Etemaj i dhanë krejtësisht tjetër fuqi asaj gazete që, fundja, ishte organ i Lëvizjes Popullore, krijueses së Ushtrisë Çlirimtare. Pa Nuhi Bytyçin do ta kisha shumë më vështirë. Disa materiale të shkruara, qindra fotografi dhe ato videoxhirime të periudhës 1997-1999 në Prishtinë dhe në zonat e luftës, disa nga të cilat u bënë imazhi i ushtrisë sonë dhe zëri i qartë i zëdhënies, panë dritën në këto dy gazeta dhe në ekranin e ndryshuar të Tiranës falë kontributit të Nuhi Bytyçit.

Disa nxënës trima të "Xhevdet Dodës", të prirë nga Arianiti (i biri i Nuhiut), po bënin me fuqinë e tyre jo vetëm një faktografi që nderon brezin e tyre në revistën "Gjimnazisti", por më shumë se kaq. Gjatë kohëve të vështira të '98-s dhe '99-s e kam pasur për nder t'u jap ato përkrahje që i kanë kërkuar, ashtu siç përshkruhen në këtë libër. Ata, sikurse tregon edhe Nuhiu: gjimnazistët e '98-99-s, Arianit Bytyçi, Besfort Rrecaj, Fiton Peja, Kreshnik Gashi, Bujar Sadiku, Albana Rexhepi, Samire Ademaj, Valbona Ruka, Vlora Çitaku, Ermal Sadiku, Kushtrim Berisha dhe nxënës të tjerë të këtij gjimnazi, të prirë nga drejtori Binak Ulaj dhe profesori Sahit Berisha, vinin në demonstratat tona. Kur u thelluam në luftë, disa prej këtyre, në mënyrë të veçantë Arianit Bytyçi, Bujar Sadiku e disa të tjerë hynin edhe në zona të luftës për t'i sjellë në faqet e gazetës së tyre imazhet frymëzuese për të rinjtë.

Libri i Nuhi Bytyçit, i ndërtuar në bazë kronologjike, me një mënyrë të sinqertë të rrëfimit, përshkruan dhe shpjegon jo vetëm në bazë autobiografike, por nëpërmjet saj edhe frymën e kohës, dramën nga afër, fragmente të historisë, ato që i ka përjetuar, parë, regjistruar e (disa) plasuar atëherë në media, që nga nisma në profesionin e gazetarisë e deri pas luftës. Do të jetë libër përkrahës për studiuesit që i qasen periudhës kulminante 1997-1999. Është për çdo respekt vullneti i Nuhi Bytyçit që ky libër i shkruar bashkë me ilustrimet përcjellëse t'u mbetet si përkujtesë gjeneratave. Ai tregon për shkrimin, zërin dhe fotografitë me të cilat u raportua për një periudhë karakteristike të historisë, kryesisht fatlume, që kulmoi me dëbimin gati tërësisht të pushtuesit serb.

Mesazhi i librit del vetvetiu nga thellësitë e rrëfimeve: për të guximshmit, në paqe apo në luftë, gjithmonë gjenden mënyra për t'i shërbyer një interesi të lartë, të përgjithshëm, ndërsa konformistët gjithmonë dinë të gjejnë arsye për mungesat e tyre. S'është për habi që kjo racë konformistësh pasi të mbarojë lufta dhe të mbretërojë thatësira e lavdisë, të rrëmbejnë dekorata e mirënjohje. Fundi i fundit, për gazetarin profesionist, shumë më i rëndësishëm është nderi pa mirënjohje sesa mirënjohja pa meritë e pa nder.

Gazetari Nuhi Bytyçi hyn në kategorinë e parë, atë të gazetarëve të guximshëm, jokonformistë. Duke i shërbyer me guxim dhe me nder interesit të Kosovës, me dëshmitë e tij të kohës, Nuhiu është në vetvete një sirtar i arkivit të luftës.

‘Libri i luftës’, libër përplot me rreziqe

Haqif MULLIQI

Çastet më të "mira" për gazetarinë janë ato kur një popull e ka më së vështiri të jetojë nga sundimi i huaj. Besoj se këtë u përpoq të na dëshmojë gazetari dhe publicisti Nuhi Bytyçi me memoaret në "Librin e luftës".

Në librat teorikë për gazetarinë shkruhet se raportimi nga lufta është kulmi i profesionit të gazetarëve. Po ashtu, se lufta është tregimi më i madh dhe më sfidues që mund të ndodhë në jetë dhe ajo "i jep gjithçka" një gazetari për t'u dëshmuar në profesion. Mirëpo, për ta dhënë kontributin e tij, të nevojshëm si profesionist, gazetari i luftës, para së gjithash, duhet të shkojë tek ajo luftë për të raportuar ashtu siç bëri miku ynë Nuhi Bytyçi, detajet e odisejadës të të cilit, si gazetar i guximshëm, profesionist dhe i përkushtuar, si kronist i një kohe, i mësojmë në lundrimin tonë si lexues, në dymbëdhjetë kapitujt e librit të tij mbi luftën dhe paqen e gënjeshtërt, që përfshin një hark kohor prej katër dekadash.

"Libri i luftës" është libër ku kuptohet se vetëm për një gazetar dhe një publicist të mirë raporti i tij me njerëzit dhe me ngjarjet, në fakt, është një luftë e vazhdueshme. Në bazë të një parimi etik mbi dilemat njerëzore të raportit ndërmjet jetës dhe vdekjes, (kjo është doktrinë që mësohet në filozofinë e gazetarisë) thuhet se nuk ekzistojnë ngjarje për të cilat ia vlen që dikush ta lë kokën. Athua është kështu?!

Është e dëshmuar se te një reporter i mirëfilltë lufte gjithmonë ekzistojnë një duzinë ngjarjesh dhe kauzash për të cilat ia vlen të rrezikohet, por edhe të mbijetohet disi, ashtu brenda ndjeshmërisë së asaj që e thotë edhe Atë Zef Pllumi, pra: "Të rrnohet vetëm për me tregue".

Nuhi Bytyçi rrezikoi shumë gjatë luftës sonë çlirimtare. Pse?

Sepse për të raportimi më i mirë nga lufta është, në thelb, një raportim kundër vetë luftës. Ai është një raportim për paqe. Një raportim për liri dhe për të ardhme. Një raportim për t'i rrëfyer ngjarjet dramatike ashtu siç ishin. Një raportim që është më shumë se kaq: një kauzë për të cilën ia vlen të rrezikohet edhe jeta.

"Libri i luftës" na tregon se zëri i Nuhi Bytyçit është i rrallë, i guximshëm në gazetarinë dhe

publicistikën shqiptare. Thjesht, një prej zërave më të veçantë që pati gazetaria jonë deri më sot. Është ai zë që e tipizon një gazetar të mirë. Që e portretizon atë duke e shkëputur nga mediokriteti në profesion.

Kjo që na solli Nuhi Bytyçi është zë kujtimesh, i cili tingëllon aq qartë në mjedisin nga i cili buroi dhe të cilit i përket plotësisht saqë nganjëherë lëviz si ndonjë kaleidioskop, ku të gjithë ne mund ta gjejmë veten tonë.

Zëri i Bytyçit në këtë libër është zë i pamëdyshur dhe i pangulfatur nga kushdo që mëtoi ta bëjë këtë gjë dhe i cili u dha jehonë të gjitha atyre ngjarjeve dhe bartësve të tyre për kohën e caktuar si dhe për brezat që do të vijnë.

E rrallë

Vjellja e balenës kushton 500 000 dollarë

Një masë e gjetur në një plazh të Tajlandës besohet të jetë vjellë nga një balenë. Masa e rrallë kap vlerën prej 500 mijë dollarësh. Boonyos Tala, 44 vjeç, gjeti masën prej rreth 10 kg teksa ecte përgjatë një plazhi në ishullin e Koh Samui në Tajlandën jugore në qershor të vitit të kaluar. Që prej atëherë, ai e mbajti masën në kopshtin e tij, pa i kushtuar rëndësi, derisa muajin e kaluar 44-vjeçarin e vizitoi një mik, duke thënë se masa mund të ishte vjellë nga balena, një substancë shumë e kërkuar nga prodhuesit e parfumeve.

FOTO E DITES

Ushtarët e Kosovës me rastin e 21-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së" në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë

E jashtëzakonshme

Ura më e rrezikshme në botë shtrihet mbi "pyllin e gurit"

"Pylli i gurit" Tsingy ndodhet në Parkun Kombëtar Tsingy de Bemahara në Madagaskar. Që nga viti 1990 ura ka qenë nën mbrojtjen e UNESCO-s falë bukurisë së pabesueshme dhe faktit se atje jeton një numër i madh kafshësh të kërcënuara nga zhdukja. Emri Tsingy përshkruan peizazhin e pabesueshëm dhe vjen nga fjala "mitsin-gitsingia", që do të thotë "duke ecur nëpër hundë". Peizazhi i pazakontë është rezultat i erozionit të tokave gëlqerore.

BARSOLETA E DITËS

Vajza: O mami, pse qielli është blu?
Mami: Pusho së foluri!
Vajza: O mami, pse breshka nuk vrapon?
Mami: Pusho së foluri po të them.
Vajza: O mami, pse babi ka dashnore?
Mami: Çka po thu?!
Vajza: Pusho së foluri, mami!

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 14:00

"SHEEP AND WOLVES" 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

"BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

""SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Ulje ngritjet e humorit ju bëjnë mjaft të lëkundshëm në marrjen e vendimeve. Mbani gjithmonë një profil të ulët në rrethin tuaj shoqëror.

DEMI
Disa takime të rastësishme do të dalin mjaft të favorshme për ju. Pasditja do t'ju sjellë pranë njerëzve të zemrës me mjaft lajme të mira.

BINJAKËT
Koha e bukur ju ka bërë edhe ju njerëz më solarë. Përfitoni nga këto ditë për të qenë në shoqërinë e personave pozitivë.

GAFORRJA
Disa kundërshti me partnerin do t'ju bëjnë nervozë sot. Njëri nga ju të dy duhet të kërkojë falje, por jeni shumë krenarë për ta bërë këtë gjë.

LUANI
Jeni mjaft idealistë, por në ditët sotme njerëzit si ju pësojnë zhgënjime të mëdha. Planetët nuk janë mbështetësit tuaj ditën e sotme.

VIRGJERESHA
Sot jeni shumë të durueshëm me mjaft situata të tensionuara që verifikohen rreth jush. Keni filluar të autocensuroni shumë gjëra.

PESHORJA
Vendosni afate kohore për gjëra që për ju janë të rëndësishme, por të tjerët nuk po i marrin seriozisht. Nëse keni nevojë për të folur, do kërkoni partnerin.

AKREPI
Mos pretendoni që zgjedhjet tuaja të mos kundërshtohen nga disa persona afër jush. Në të kundërt do dukej sikur keni persona fals rreth vetes.

SHIGJETARI
Sot do të mësoni një lajm që nuk do t'ju pëlqejë lidhur me jetën tuaj sentimentale. Do të ngushëlloheni duke i bërë dhurata vetes.

BRICJAPI
Energjia juaj nuk ju lë sot të bini pre e plogështisë ose e lodhjes. Edhe pse do të jeni të ngarkuar do të përballoni çdo situatë.

UJORI
Keni njohur persona të rinj kohët e fundit, por nuk dini si t'i kategorizoni. Jeni disi në panik sepse nuk dini t'u besoni apo jo.

PESHQIT
Sot do të jetë ditë shumë e mirë sepse do të zbuloni se sa sintoni ka mes jush dhe një personi që sapo e keni njohur. Flirte të reja në horizont.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	PORTO - ROMA	1	PSG- UNITED	GG3+	LUZERN - YONG BOYS	2

Haliti: Mposhtim Feronikelin dhe zbusim diferencën

Derbi më i madh i këtij edicioni në Superligë zhvillohet sot në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse përballë do të jenë skuadra e parë në tabelë, Feronikeli dhe e dyta, Prishtina. Kryeqytetasit synim të vetëm kanë fitoren në mënyrë që ta zbusin diferencën në tri pikë, kurse "Nikli" do ta pranonte me dëshirë edhe barazimin, pasi diferenca e pikëve do të mbetej e pandryshuar. Ndeshja fillon në orën 17:00 dhe drejtohet nga gjyqtari Dardan Çaka

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 5 MARS - Mbrojtësi Ahmet Haliti është shumë optimist se skuadra e Prishtinës do ta mposhtë Feronikelin në derbin e javës së 21-të në IPKO Superligë dhe në këtë mënyrë do ta zbusë diferencën e pikëve. Në fakt, Prishtina sot në stadiumin "Fadil Vokrri" e pret Feronikelin nga ora 17:00. "E njoh shumë mirë skuadrën e Feronikelit. Kam luajtur dy vjet aty. Ka shumë cilësi dhe është në formë të mirë. Por neve nuk ka intereson fare ekipi kundërshtar. Ne duhet ta shohim vetëm veten. Gabimet që i kemi bërë në ndeshjet e fundit duhet t'i përmirësojmë dhe normalisht në ndeshje të hyjmë vetëm për fitore për ta zbutur distancën që e kemi ndaj tyre. Megjithatë, duhet t'i qasemi me mjaft qetësi ndeshjes, duke mos hyrë me eufori dhe shpresoj se me një lojë të mirë t'i arrijmë tre pikë që janë shumë të nevojshme për ne në këtë kohë", ka thënë Haliti për faqen zyrtare të skuadrës kryeqytetase.

Për ndeshjen ndaj Prishtinës foli edhe kapiteni i Feronikelit, Lapidar Lladrovci, i cili për "Epokën e re" ka thënë se derbi që zhvillohet sot do të jetë ndër më interesantit në këtë kampionat. Lidhur me synimet e skuadrës nga Drenasi në këtë përballje, Lladrovci ka konfir-

muar se edhe barazimi do të ishte rezultat i pranueshëm. "Ndeshja me Prishtinën është një nga ndeshjet më të rëndësishme të sezonit për ne ngaqë luajmë me rivalin e drejtpërdrejtë për titull. Një fitore eventuale do të na shkëputste me tetë pikë në krye të tabelës, ndërsa edhe barazimi nuk do të ishte rezultat i keq, pasi do të na mbante pesë pikë para. Megjithatë, ka edhe shumë ndeshje për t'u luajtur, andaj edhe kjo ndeshje ka rëndësinë si ajo e kaluara ndaj KEK-ut, pra luhet për tri pikë. Do të jetë një ndeshje e bukur pasi kushtet në stadiumin 'Fadil Vokrri' janë fantastike, ku terreni do të na lejojë të tregojmë gjithë potencialin tonë. Besoj se të gjithë tifozët do të kënaqen me lojën që do të tregojmë. Jemi shumë të motivuar dhe mezi e presim fillimin e ndeshjes", ka deklaruar Lladrovci.

FC Prishtina ka njoftuar se interesimi për këtë ndeshje është më i madhi ndonjëherë për ndeshjet kampionate, pasi mbi 30 gazetarë do ta përcjellin nga afër derbin e sezonit në elitë.

Drita përmbysi Ballkanin

Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, e ka mposhtur Ballkanin (1-2) në ndeshjen e parë të javës së 21-të. Skuadra vendëse e nisi më mirë ndeshjen dhe arriti që pas trembëdhjetë minutave lojë të kalojë në epërsi me golin e shënuar nga Jetmir Topalli, por gjilanasit nuk u dorëzuan dhe shënuan dy gola në pjesën e dytë për t'i marrë pikët maksimale.

IPKO SUPERLIGA

Ballkani - Drita 1-2

Sot takohen:
13:30 Trepça '89 - Liria
13:30 Drenica - Flamurtari
13:30 Gjilani - Llapi
13:30 Ferizaj - KEK-u
17:00 Prishtina - Feronikeli

TABELA

		PIKË
1. Feronikeli	20	48
2. Prishtina	20	43
3. Llapi	20	41
4. Drita	21	32
5. Gjilani	20	29
6. Trepça '89	20	28
7. Drenica	20	27
8. Ballkani	21	27
9. Flamurtari	20	26
10. Ferizaj	20	21
11. Liria	20	20
12. KEK-u	20	1

Fillimisht rezultatin e barazoi Haxhi Neziraj në minutën e 57, kurse në minutën e 71-të Kyrian Nwabueze vulosi rezultatin final 1-2. Drita aktualisht zë vendin e katërt me 32 pikë, kurse Ballkani në vendin e tetë ka 27 pikë.

MKRS-ja, mbi një milionë euro për 18 federata sportive

PRISHTINË, 5 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në kuadër të mbështetjes financiare për federatat e sportit, ka nënshkruar të martën memorandume bashkëpunimi edhe me 18 federata të tjera sportive. Shuma totale e mbështetjes financiare arrin mbi një milion euro. Sipas memorandumeve të nënshkruara, Federata e Atletikës mbështetet me 101 465 euro, Federata e Autosporteve me 37 812 euro, Federata e Karatesë me 172 mijë euro, Federata e Boullingut me 42 048 euro, Federata e Aeronautikës me 37 128 euro, Federata e Mundjes me 57 468 euro, Federata e Bodybuldingut dhe Fitnesit me 46 692 euro,

Federata e Peshëngritjes me 43 644 euro, Federata e Shigjetarisë me 49 032 euro, Federata e Taekwondos me 53 112 euro, Federata e Bjeshkatarisë Alpiniste me 19 688 euro, Federata e Gjimnastikës me 52 428 euro, Federata e Punëtorëve Sportivë 16 704 euro, Federata e Shenjëtarisë me 49 116 euro, Federata e Tenisit me 59 484 euro, Federata e Boksit me 55 716 euro, Federata e Notit me 86 537 euro dhe Federata e Sporteve Universitare me 22 856 euro.

Ministri Kujtim Gashi ka thënë se përkrahja e MKRS-së për federatat iu mundëson atyre të kenë mundësi t'i realizojnë objektivat dhe planet e tyre për vitin 2019. Ai u shpreh se angazhimi si institucion në mbështetje të sportit në vend nuk do të mbarojë me kaq dhe se do të bëhen edhe më tutje investime në përmirësim të kushteve për sportistë. "Me këto memorandume krijohen lehtësira për federatat në mënyrë që ato të funksionojnë me efikasitet sa më të plotë, të pavarura dhe t'i realizojnë aktivitetet e planifikuara në funksion të avancimit të mëtejmë të sportit të Kosovës", ka thënë Gashi.

Ndërsa drejtuesit e këtyre federatave falënderuan ministrin për pritjen dhe përkrahjen që po i ofron sportit dhe sportistëve të vendit. Ata u shprehën të kënaqur me mbështetjen që MKRS-ja u ofron atyre, sidomos me memorandumet, me çfarë ndihmohet veprimtaria e federatave për realizimin e planprogrameve të tyre për avancim të sportit.

Sonte Prishtina përballet me Pallacanestro Varese

PRISHTINË, 5 MARS - Z Mobile Prishtina, pasi e shkroi historinë muajin e kaluar duke u kualifikuar në mesin e 16 skuadrave më të mira të FIBA Europe Cup, sonte (e mërkurë) përballet me skuadrën e famshme italiane Pallacanestro Varese. Prishtina u bë skuadra e parë shqiptare që arriti këtë sukses falë fitores ndaj skuadrës turke Pinar Karsiyaka me rezultat 82-78. Tash kryeqytetasit e Kosovës përballë e kanë kampionen e dhjetëfishtë të Italisë dhe pesëfishtë të Evropës. Megjithatë, Prishtina me përkrahjen e "Plisave" synon ta befasojë edhe skuadrën italiane. Përballja në mes të Prishtinës dhe Pallacanestro Varese fillon nga ora 20:30 dhe transmetohet drejtpërdrejt edhe në kanalin "ArtSport 1" në platformën "Artmotion".

Lowi largon tre lojtarë të Bayernit nga kombëtarja

MUNCHEN, 5 MARS - Trajneri i Kombëtares së Gjermanisë, Joachim Low dhe menaxheri Olivier Bierhoff kanë shkuar në Munchen të martën për t'u komunikuar një vendim tri figurave që kanë dhënë shumë për katër herë kampionët e botës.

Cili është vendimi?
Mats Hummels, Jerome Boateng dhe Thomas Muller s'do të jenë më pjesë e Gjermanisë. Lowi shpjegoi se ky vendim vjen si pasojë e një strategjie për t'i hapur rrugën brezit të ri në skuadër dhe në fund i falënderoi të tre lojtarët për kontributin e tyre. "2019-ta është viti që sinjalizon një fillim të ri për kombëtaren e Gjermanisë. Duam ta vazhdojmë planin e ndryshimeve që vazhduam gjatë fundit të vitit të kaluar. Boateng, Hummels dhe Muller nuk do të jenë më në skuadër. Erdha në Munchen për t'ua komunikuar atyre personalisht këtë gjë. Ata mbeten lojtarë klasi, të cilët janë liderë te klubet e tyre. Janë futbollistë të mëdhenj, që kanë luajtur për një kohë të gjatë për kombëtaren gjermane. Kanë kaluar shumë vite më ne. I falënderoj për vitet e paharrueshme që kaluam së bashku", ka thënë Low.

Unitedi i 'plagosur' synon përmbysjen e PSG-së

PARIS, 5 MARS (ER) - Manchester United përballet sonte (e mërkurë) me Paris Saint-Germain në Ligën e Kampionëve kurse, përveç disavantazhit prej dy golave, trajneri Ole Gunnar Solskjaer nuk do të ketë në dispozicion shumë lojtarë si Ander Herrera, Jesse Lingard, Nemanja Matiq, Anthony Martial, Juan Mata, Phil Jones, Antonio Valencia, Paul Pogba dhe Alexis Sanchez. Mirëpo kjo nuk e ka penguar trajnerin Solskjer që të kërkojë një fitore në Paris me rezultat 2-4. "Nuk mund të themi se ndeshjet e tilla janë të pamundura. Ne kemi qenë fantastikë në ndeshjet jashtë shtëpisë. Nuk do të pranojmë të eliminohemi pa luftuar paraprakisht. Ne do të shkojmë atje dhe do ta shijojmë ndeshjen. E dimë që është një vend i vështirë për të shkuar dhe ata luajtën shumë mirë në 'Old Trafford'. Kjo është një sfidë e mrekullueshme për lojtarët tanë, të shkojnë atje dhe ta dëshmojnë se çfarë mund të bëjnë. Ne preferojmë të fitojnë 4-2 sesa 2-0. Duhet të dalim nga pjesa e parë më mirë sesa që jemi tani. Nëse mund ta bëjmë rezultatin 1-0 në favor tonin në fund të

pjesës së parë, atëherë gjithçka mund të ndodhë në pjesën e dytë", ka deklaruar Solskjer. "Kundër PSG-së, në 20 minutat e fundit, ata e dinin se po fitonin 2:0 dhe ishin të lumtur, por unë mendoj se ne u treguam mjaft të mirë dhe Victor Lindelof ishte fantastik në mbrojtje. Ne mund të shkojmë atje, ta shënojmë një gol dhe të krijojmë kaos në 15 apo 20 minutat e fundit", ka shtuar Solskjer.
Për këtë ndeshje ka folur edhe mbrojtësi i PSG-së, Dani Alves. Ky i fundit ka thënë se skuadra franceze nuk duhet të bazohet në rezultatin e ndeshjes së parë, por të jetë e përqendruar maksimalisht edhe në ndeshjen e dytë. "Ne bëmë një hap të madh në ndeshjen e parë, por nuk mund të flemë mbi dafina. Ne e dimë se në futboll mund të ndodhë gjithçka. Duhet ta përsërisim punën e shkëlqyer që bëmë në 'Old Trafford'. Të mos bazohemi te rezultati i ndeshjes së parë, por të arrijmë një rezultat tjetër pozitiv", ka thënë Alves.
Përveç kësaj ndeshje, nga ora 21:00 zhvillohet edhe ndeshja në mes të Portos dhe Romës.

SONTE TAKOHEN:	
Porto - Roma	(1-2)
PSG - Man Utd	(2-0)

Clippersat fitojnë derbin ndaj Lakersave

LOS ANGELES, 5 MARS - Lakers i largohen gjithnjë e më shumë zonës "play-off" dhe humbja në derbin e Los Angelosit ndaj Clippersave me rezultatin 113-105 e konfirmon këtë gjë. Ndeshja ishte në përgjithësi e ekuilibruar, por në periodën e fundit skuadra e Clippers nis shkëputjen dhe fiton falë 23 pikëve të Gallinarit e 21 pikëve të Lou Williams. LeBron James realizoi 27 pikë e Kuzma një "trible double" (24 pikë, 10 rebound e 12 asistime), por që mbetën për statistikë. Fitore në sekondën e fundit për San Antonio, që mundi 104-103 Denver, një përballje mes dy ekipesh pretendente për titull në Perëndim. Spurs e dominuan ndeshjen shumicën e kohës, por në fund rrezikuan ta humbisnin atë. DeRozan me 24 pikë e Aldridge me 22 bënë diferencën për San Antonio, duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e Murray dhe 22 të Jokiq. Sukses "in extremis" edhe për

Miami, që mposhti 114-113 Atlanta, ndeshje ku rivaliteti ishte i madh. Veterani Dwyane Wade ishte ai që i dha fitoren Miami, me 23 pikë. Tjetër humbje për Milwaukee, që u mund 114-105 nga Phoenix dhe humbet disi kontaktin me kreun në Lindje (Oubre 27 pikë e 13 rebound). Brooklyn mundi me lehtësi 127-88 Dallas (Carroll 22 pikë), ndërsa New Orleans triumfoi 115-112 ndaj Uah Jazz falë Rundle e Holiday, që realizuan nga 30 pikë secili.

REZULTATET	
Brooklyn - Dallas	127-88
Miami - Atlanta	114-113
San Antonio - Denver	104-103
Phoenix - Milwaukee	114-105
Utah Jazz - New Orleans	112-115
Sacramento - New York	115-108
Lakers - Clippers	105-113

SHKURT

Panucci mund ta braktisë Shqipërinë për Romën

Di Francesko është në fije të perit dhe vetëm një kualifikim në Portugali ndaj Portos mund ta shpëtojë karrierën e tij te Roma. Mediet italiane kanë bërë aludimet se kush mund të jetë ai që do ta zëvendësojë në rast të një dështimi në Ligën e Kampionëve. "Sky Sport" ka listuar emrat që mund ta zëvendësojnë. Tri janë pistat më të besueshme, Paolo Soza, i cili më parë ka drejtuar Fiorentinën, Roberto Donadoni dhe i treti është Christian Panucci i kombëtares shqiptare. Trajneri i Shqipërisë cilësohet kandidat i fortë për ta marrë stolin e ish-ekipit të vet. Megjithatë, ai ka një kontratë me FShF-në dhe i duhet të zgjidhë sa më parë. Kjo nuk është hera e parë që Panucci lakohet për një kalim te Roma, pasi ka ndodhur edhe më parë, duke parë se çfarë përfaqëson për klubin.

Pele: Liverpooli e fiton titullin në Angli

Liverpooli dhe Manchester City po luftojnë fuqishëm për titullin e kampionit në Premierë Ligë, por legjenda e futbollit brazilian dhe botëror, Pele, beson se skuadra e Jurgen Kloppit do të shpallet kampione e Premierligës. "Urime ditëlindja për heroin e Liverpoolit, Kenny Dalglish! Unë besoja se Liverpooli do ta fitojë titullin e Premierligës që nga fillimi dhe ende besoj se mund ta arrijnë këtë gjë", ka shkruar Pele në "Twitter". Aktualisht Manchester City është në pozitën e parë me dy pikë më shumë se Liverpooli.

Gnabry rinovon kontratën me Bayernin

Serge Gnabry e ka rinovuar kontratën me kampionët në fuqi të Gjermanisë, Bayern Munchen, deri në vitin 2023. I blerë në verën e vitit 2017 nga Werder Bremeni për 10 milionë euro, anësori i krahut të majtë këtë sezon ka arritur të ketë hapësira dhe të realizojë 6 gola në Bundesligë. Në të shkuarën ai ka qenë pjesë e Arsenalit dhe më pas spikati te Werderi dhe Hoffenheim. "Ndihem me të vërtetë shumë mirë këtu. Jam shumë i kënaqur me këtë skuadër dhe shpresoj të fitoj shumë tituj dhe të përjetoj çaste të mrekullueshme. Shikoj një të ardhme të mirë me Bayernin", ka thënë Gnabry.

Gjashtë lojtarë do të largohen nga Reali

Ky sezon që po vijojmë është një nga më të dobëtit për Realin e Madridit në vitet e fundit. Eliminimi nga Kupa dhe ecuria jo e mirë në kampionat kanë bërë nisjen e dështimit deri tani për "Los Blancos". Pa dyshim që nëse do ta fitonte Ligën e Kampionëve, skuadra e Solarit do të shuante çdo kritikë që është bërë deri tashmë për të. Fajin për këtë sezon jo të mirë e ka klubi, trajneri dhe lojtarët. Trajneri me shumë mundësi në fund të sezonit nuk do të jetë në krye të skuadrës. Por, sipas spanjolles "AS", nuk do të jenë as gjashtë lojtarë që do ta marrin valixhen në dorë dhe do të kërkojnë një shtëpi të re. Bëhet fjalë për Bale, Vajeho, Mariano, Marcelo, Isco dhe Brahim Dias. Të gjithë këta lojtarë ose nuk luajnë pak ose nuk luajnë fare për Realin.

Bakayoko: Do ta kualifikoj Milanin në Ligën e Kampionëve

Tiemoue Bakayoko, që është i huazuar nga Chelsea, me drejt blerje për 35 milionë euro, është i lumtur te kuqezinjtë dhe ka thënë se do ta japë maksimumin që të arrihen objektivat e klubit. "Po kaloj në një sezon të mirë. I jam falënderues Milanit dhe jam shumë i lumtur këtu, edhe pse jam kritikuar shumë në fillim. Është normale. Të gjithë kanë pritur më shumë nga unë. Nuk është befasi. Do të bëj gjithçka për t'i siguruar Milanit kualifikimin në Ligën e Kampionëve për sezonin e ri. Kanë kaluar pesë vjet që kur tifozët e Milanit kanë dëgjuar për herë të fundit himnin dhe unë dua të jem në 'San Siro' ku të ndodhë kjo", ka thënë Bakayoko për "France Football". "Do të shikojmë se si do të përfundojë sezoni. Unë kam kontratë me Chelsean. Ai është klub shumë i rëndësishëm për mua. Ai vendosi të bëjë disa ndryshime dhe unë nuk isha pjesë e planeve të tij. Sarri erdhi dhe më tha cilat ishin qëllimet e tij. Ishte një vendim i rëndësishëm për mua sepse Milani është klubi im i katërt për mua dhe për një 24-vjeçar është shumë. Ishte Leonardo ai që më kontaktoi dhe u largova nga Chelsea vetëm për Milanin pasi ishte klubi që më bëri të ëndërroja kur isha fëmijë", ka shtuar Bakayoko.

Universiteti i Prishtinës

"Hasan Prishtina"

Fakulteti Ekonomik, Prishtinë

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit, se me datën 15.03.2019 (e premte) në ora 13.00, në Fakultetin Ekonomik (salla e profesorëve), kandidatja *MSc. Vjosa Fejza*, i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës, me temën: "**Modelet e sjelljes konsumatore në sektorin e bankave në Kosovë**", me mentor *Prof. Dr. Ramiz Livoreka*, para komisionit profesional, në përbërje prej: *Prof. Ass. Dr. Hykmete Bajrami* - kryetare e komisionit, *Prof. Asoc. Dr. Fatos Ukaj*- anëtar i komisionit, *Prof. Dr. Vjollca Hysi Panajoti* - anëtare e jashtme e komisionit (Universiteti i Tiranës).

Shkolla e Mesme e Profesionale
" Ymer Prizreni " Prizren
Kosovë 20000 Prizren rr.Bajram Curri pn
Nr.tel.038/20035377
e-mail:mgavazaj@hotmail.com
facebook:shmel"Ymer Prizreni"

Nr.208 dt.06.03.2019

Mbështetur në nenin 11, të Udhëzimit Administrativ Aktivitete jashtëshkollore – Ekskursionet shkollore nr. 2/2016 të datës 12.01.2016, në bazë të Vendimit të KDSH, të datës 04.03.2019 nr. 205 , Këshilli Drejtues i shkollës "Ymer Prizreni" në Prizren harton këtë :

FTESË PËR OFERTË

Për ekskursionin e maturantëve të SHMLP "Ymer Prizreni"në Prizren në Republikën e Shqipërisë .

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Kompanitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të SHMLP "Ymer Prizreni"në Prizren për në Republikën e Shqipërisë ,më datën 29.04.2019 deri me 04.05.2019

Pjesëmarrësit e interesuar në tender për dokumentacionin dhe kushtet e kërkuara nga ana e shkollës i kanë të paraqitura në aplikacion.

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimeve mund t`i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuar me dokumentacionin të dorëzohen në DKA në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë kalendarike, nga dita e publikimit në gazetë .

Të interesuarit aplikacionet mund t`i tërheqin në lokalet e shkollës prej orës 8:00 deri në orën 15:00 dhe atë gjatë ditëve të punës.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve nuk mund të bëhet ditën e shtunë dhe të diel, për shkak se këto dy ditë nuk punon administrata e shkollës.

Shkolla mban të drejtën për anulimin e ofertës.

Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi im. Eksperienca ime - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 01.03. 2019 deri më 10.03.2019.



Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës:	**"Saih Bytyçi"**-Shkozë
Komuna:	Malishevë

Data: **6 mars 2019**

Emri i kontratës: *Blerja e mjeteve konkretizuese për shkencat e natyrës dhe arteve.*
Numri i kontratës: **ESIP/C1.3/056-ESIP/SDG/056-G/1.2**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Salih Bytyçi", Shkozë-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
   - *Pajant me mjete konkretizimi për Fizikë– 1 cope*
   - *Pajant me mjete konkretizimi për Kimi - 1 cope*
   - *Mjete konkretizimi për Biologji-1 cope*
   - *Mjete konkretizimi për Art dhe Muzikë – 1 cope*

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën Adresa e Shkolles **Salih Bytyçi,Shkozë- Malishevë** më së largu deri më **14 mars 2019.**

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Arben Bytyçi, Hajrush Bytyçi, Defrim Berisha
Telefoni: 044536234, 044289208 , 049360839
E-maili: beni-1988@live.com

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave –Ministarstvo za Finansije- Ministry of Finance
Agjencioni Qendror i Prokurimit /Centralna/Agencia/
Nabavke/Central/Prokurment/Agency

KONKURS

Duke u bazuar ne Ligjin nr.03/L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencioni Qendror i Prokurimit, shpall konkurs për ketë vende punë.

1. Titulli i postit : Drejtor Drejtorisë për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
Koeficienti: Nëntë pikë pesë (9.5)
Numri i Referencës së vendit të punës:12/2019
Përgjegjës Mbikëqyrës: PO
I Raporton: Drejtorit të Përgjithshëm të AQP-së
Orar i Plotë i punës: PO
Vendi: Prishtinë

Qëllimet e Vendit të Punës: Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde lidhur me buxhetin, financat, burimet njerëzore, logjistikën e institucionit dhe teknologjinë informative.

Detyrat dhe Përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm, kryen detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Udhëheq drejtorinë dhe cakton objektivat e tij në pajtim me strategjinë dhe objektivat e agjencisë dhe harton plane të punës vjetore të detajuara për të përmbushur këto objektiva 20%

2. Menaxhon stafin dhe buxhetin e drejtorisë dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit 15%

3.Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë 10%

4.Menaxhon procesin e planifikimit, rekrutimit, vlerësimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzorë si dhe mirëmbajtjen e sistemit të informatave për menaxhimin e burimeve njerëzore të agjencisë 15%

5.Mbështet dhe koordinon planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit në përputhje me objektivat e agjencisë 15%

6.Sigurimi i shpenzimeve financiare në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore dhe kontrolli i brendshëm financiar është i bazuar në parimet e llogaridhënies 10%

7. Siguron ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative, logjistikës, transportit dhe arkivimin e dokumenteve dhe shërbimeve tjera administrative për agjencinë 10%

8. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve, për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara 5%.

Kualifikimet, Përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë Universitare apo te avancuare, 6 vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku 3 vite në pozitë drejtuese;
- Fakulteti Ekonomik-Juridik;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e buxhetit dhe financave, burimeve njerëzore, teknologjisë informative dhe shërbimeve administrative;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim, njohuri të mire për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit ;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, internet);
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve.

INFORMATË E PËRGJITHËSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve te Kosovës.
Komuniteti jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil, siç e specifikon Neni11,paragrafi 3,i Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Dokumentacion i kërkuar për aplikim:

Kopje e vërtetuar e diplomës:
Vërtetim mbi përvojën e punës (ose dëshmi nga Trusti Pensional)
Kopje e letërnjoftimit.

